HUNGARY ALBANIA BOSNIA AND HERZEGOVINA CROATIA MONTENEGRO SERBIA SLOVENIA

FOREVER

January 2014 | XVIII Issue 01

2014

Happy New Year

NUK KA KOHË MË TË MIRË SE E TANISHMJA

Rex Maughan
I juaji

Fillimi i vitit të ri është gjithmonë një moment reflektimi.. Reflektimi për alternativat tona, për të parë sa na kanë çuar ato në sukses apo në dështim është një hap jashtzakonisht i çmuar për të ecur përpara. Në qoftë se përsërisni të njëjtat gabime, nuk mund të prisni që rezultati në fund të jetë ndryshe. Por në qoftë se ju arrini të mësoni nga sukseset dhe ti dyfishoni ato hapa që ju kanë çuar në atë sukses, atëhere 2014 do të jetë plot me mundësira.

Gjatë vitit 2013 ne arritëm kaq shumë suksese të mrekullueshme! Unë jam shumë krenar për të gjithë ju që u bëtë pjesë e biznesit të Foreverit për të realizuar endërrat dhe ambicjet tuaja. 2014 është një faqe bosh, dhe jeni ju ata që do të shkruani në të objektivat tuaja si dhe rrugët për realizimin e këtyre objektivave. Për arritjen e objektivit ka disa rrugë. Pavarësisht se cila rrugë është më e përshtatshme për ju, mesazhi shtytës përpara është i njëjtë: nuk ka kohë më të mirë se tani për të filluar.

FRYMËZOHUNI

Kalo një pjesë kohe me njerzit që i admiron. Unë gjithmonë jam i rrethuar nga punonjës që më frymëzojnë. Nga distributorët, nga familja, nga ata jeta e të cilëve ka ndryshuar nga Foreveri. Nuk arrij tua them sa energji dhe kurajo marr nga njerzit që më rrethojnë! Duke krijuar mardhënie të forta dhe që të mbështesin ju ndihmon të fitoni besimin që të çon te suksesi. Programoje kohën për tu takuar rregullisht me sponsorin tuaj dhe me ata që ti ke sponsorizuar. Përmes këtij komunikimi të vazhdueshëm dhe bashkpunues ju do të ndihmoni njeri tjetrin në arritjen e objektivave tuaja.

ORGANIZOHUNI

Pas reflektimit për 2013 dhe përcaktimin e objektivave të 2014, lini pak kohë planifikimit të rrugës për realizimin e objektivave. Qoftë objektivi për shtimin e të ardhurave tuaja, apo për fitimin e çekut të Chairman'Bonus, planifiko rrugën që do të çojë atje. Sa telefonata apo lidhje të reja do të duhen? Sigurohu për krijimin e listës, për të mos mbetur jashtë listës së ardhshme të menaxherëve Eagle. Planifikimi i këtyre gjërave do tju ndihmojë të siguroni që ju të qëndroni në rrugën arritjes të objektivave tuaja.

VAZHDO TË ECËSH

Sapo të kesh skicuar rrugën që do të ndjekësh për arritjen e objektivave, filloja punës! Vetëm të bësh plane nuk mjafton. Sa herë që bllokohem apo më zvarritet ndonjë gjë, unë kujtoj të ashtuquajturin „Rregull i 2 minutëshit". Rregulli i 2 minutëshit do të thotë që në qoftë se diçka mund të bëhet në më pak se 2 minuta, atëhere atë bëje që tani. Duke bërë një thirrje telefonike apo duke dërguar një E-mail, ju keni nisur rrugën për suksesin e vitit 2014. Sa më shumë nga këto detyra 2 minutëshe ju realizoni, aq më i madh do të jetë besimi tek vetja, aq më shumë ka të ngjarë të realizoni objektivat tuaja.

Në qoftë se ju ndiqni këto këshilla të thjeshta, ju do të befasohi sa i begatë do të jetë 2014. Ju këshilloj të bëni një plan dhe ti përmbaheni atij! Së bashku le ta bëjmë 2014 një nga vitet më të mirë që kemi patur ndonjëherë!

Dr. Sándor Milesz
Drejtor i Përgjithshëm

PERSPEKTIVA

Ja përsëri viti i ri plot urime, shpresa e dëshira…po, ndofta për ata që mendojnë në mënyrë tradicionale, por neve jemi Forevera!

Çdo të thotë për ne Viti i Ri? Planifikim, ekonomizim i kohës, objektiva, rezultate, suksese, argëtim, pushim, shëndet e mirëqënie. Kjo tingëllon shumë më mirë, se sa të presësh çudira për dyzet vjet me radhë si skllav…

Çudia nuk vjen vetvetiu, për atë duhet punuar shumë, jashtzakonisht shumë.

Edhe tani në festë, brënda vetes më nxit një dëshirë të shkruaj për një Perspektivë, që mund të fillojë edhe për ty, madje që sot, vetëm zgjoju më në fund, jo nga zilja që të kërkojnë në punë, që sidoqoftë nuk e duron dot, as shefi nuk është normal, vetëm të kërkon vazhdimisht, paret nuk duken kërkund, ndërsa borxhet rriten vazhdimisht…Pra e kam fjalën për një zgjim të vërtetë, e kam fjalën për zgjimin tënd. Të lutem, shikohu në pasqyrë, sa vjeç je, kështu duhet të dukesh, si e ke lëkurën e faqes, si i ke sytë, a je i kënaqur me veten?

Gjerb kafenë e mëngjezit, fëmijët presin mëngjezin në tavolinë, a ua ke siguruar?. A ua ke blerë ato dhurata që të kanë kërkuar? Sigurisht i ke edukuar me kërkesa modeste. Pse? Edhe atyre do që tu heqësh Perspektivën? Je përgjegjës për ta, për nipërit e mbesat e tua. Edhe sikur tetëmbëdhjet vjeç të jesh, tani duhet të hedhësh bazat e një të ardhme më të bukur!

A ke dëshirë për një vilë në bregdet, që fëmijët tuaj të lozin në rërë, që para garazhdit të qëndrojë bashkshortja jote me veturën e bukur dhe për mëngjez të të sjellë fruta? Të ulesh para kompiuterit të shikosh mesazhet që të vijnë, të dalësh në taracë dhe të vrapojnë drejt teje fëmijët e gëzuar, të të puthin, të hash i gëzuar mëngjezin e të përqafosh fort bashkshorten tënde, kjo është jeta e bukur… Sipas meje, diku thellë edhe ti e ke këtë dëshirë, shikoju në pasqyrë dhe thuaj vetes të vërtetën!

Perspektiva është e mrekullueshme, por për të duhet punuar…pse nuk punon që tani? Çfarë fiton? Je i kënaqur? Sigurisht, që nuk je, shumë më tepër do të doje, atëhere vendos më në fund, mjaft ndejta, po filloj, do thërras sponsorin tim! Atëhere thirre, thirre tani, jemi në janar, nuk është vonë. Beso më në fund tek vetja, sa shumë njerëz janë ngjitur në podiumin e skenës. Edhe ti do të ngjitesh atje!

Unë po pres…

Të ardhme të bukur, Forever!

Success Day

BUDAPEST, 16 NËNTOR 2013

NË FOREVER ÇDO DITË SUKSESI ËSHTË FESTIVE, SEPSE NË KËTË KOHË VLERËSOJMË ARRITJET E KOLEGËVE TANË. FUNDI I VITIT ËSHTË AKOMA MË FESTIV: DËSHIROJMË TË JEMI METË DASHURIT TANË, MBYLLIM VITIN: HEDHIM NJË VËSHTRIM MBRAPA..., POR MBI TË GJITHA PËRPARA!

Me këtë rast **dr. Terézia Samu dhe András Bruckner** soaring menaxherë si një lloj Babagjyshërish të Vitit të Ri të Foreverit nuk ju dhanë dhurata vetëm fëmijëve, por edhe neve me menaxhimin e plotë të Ditës së Suksesit. Ata deklarojnë: ja dinë për nder FLP-s dhe produkteve të saj, që sot mund të jetojnë një jetë të gëzuar, dhe kanë kohë të mjaftueshme për familjen. Ndërkohë krahas saj kanë shëtitur botën... Përshëndesin të pranishmit, dhe më pas ftojnë drejtorin e përgjithshëm të Foreverit për Hungarinë dhe rajonin, **Dr. Sándor Mileszin**. Ai e drejton rajonin prej gjashtëmbëdhjet vjetësh si dhe ka edhe grupin e vet si zafir menaxher. Është babai i gjashtë fëmijëve dhe antarë i Urdhrit të Maltës. "Mbyllëm një vit fantastik - thotë ai - ishte vit i fort por vendimtar në historinë tonë." Evenimentet e vitit mund ti shohim edhe në video duke filluar nga e para Ditë Suksesi dhe nga Trajnimi Diamant i pari në histori, nga Rally Global në Hawaii e deri në trajnimin në Opatija. "Duke e llogaritur për frymë popullsie jemi akoma të parët në botë! - sqaron Dr. Sándor Milesz -, faleminderit juve, është kënaqsi të punosh me një grup të tillë! Këtu të gjithë kanë një qëllim të përbashkët: të rritet xhirua e rajonit. Këtë viti bëmë, atë që shumë nuk dinë ta bëjnë: kemi dalë përsëri nga gropa ku kishim rënë, dhe kemi përsëri xhiro më të mirë, se vjet në këtë periudhë. Për momentin në rajon një në çdo njëmijë veta përdor produktet tona; do të dëshiroja që të ishin dy herë më shumë. Për këtë i kemi të gjitha shpresat: tani hodhëm bazat, që në 2014, 15, 16 të oshëtijë. Ju uroj juve sa më shumë xhel, sa më shumë tableta, energji shpërthyese për çdo ditë, ambjent familjar paqësor e të qetë, festë të bekuar, Vit të Ri të lumtur!

Pas përshëndetjes mundëm të dëgjojmë një leksion profesional nga **dr. Edit Révész Siklósné** anesteziologe, mjeke specialiste për reanimacion, Soaring menaxhere. Është drejtuese e grupit të mjekëve specialist të Foreverit hungarez, është dekoruar me urdhër merite për mjeksinë alternative dhe pranon që është e dashuruar me produktet. Tema aktuale e saj është: „Mënyra e jetesës në dimër". Mot i ashpër, mjergulla të shpeshta, smogu, dritë e pakët, ditë me lëvizje të varfëra, ushqime me shumë yndyrna: periudha e ftohtë sigurisht që nuk është e favorshme për shëndetin tonë. Në këtë kohë kemi nevojë për më shumë ajrosje, hidratim lëkure, kompesim të vitaminës D dhe për sa më shumë lëngje. Duhet të kujdesemi për veten edhe më mirë se e përgjithshmja: në periudhën e sëmundjeve gjendja e sistemit imunitar është vendimtare. Lëvizja 30 minutëshe në ditë mund të hedhë bazat e një fiziku të mirë, ndërsa tek ushqimi ka rëndësi marrja me bollëk e vitaminave, zëvendësimi i antioksidantëve, marrja e acideve yndyrore të pangopura dhe detoksifikimi. Ndihmësit tanë në mbrojtje mund të jenë lëndë të ndryshme anti-inflamatore dhe antiseptike, vitamina dhe antibiotikë natyrale.

Më tej vazhdon një zakon i dashur: në skenë priten përfaqësuesit e gjeneratës së ardhëshme të konsumatorëve dhe ndërtuesve të rrjetit: fëmijëve ju jep dhurata Babagjyshi i Vitit të Ri dhe ndihmësja e tij: çifti Bruckner-Samu. Si zakonisht fëmijët çuditërisht dinë shumë për produktet, dhe kush më i turpshëm, e kush më i guximshëm, i thonë në mikrofon.

Dr. László Jakab është mjek veteriner pensionist në Vác, e veç kësaj menaxher me të drejtë autori. Mban leksionin me temë "I dua blerësit e mi", nga e cila duket, që këtë zanat nuk mund ta bësh ndryshe, veçse me dashuri. László është përdorues produktesh prej katër vjet e gjysëm. Ai tregon: nuk ka ndryshim të madh midis organizmit të njeriut dhe të kafshës, kështu me disa përjashtime, e gjithë marka e plotësuesve ushqimorë mund të përdoret në veterinari. Xheli aloe të mbron, ushqen dhe ndihmon për një cilësi jete më të mirë. Dhe çfarë është të paktën po kaq e rëndësishme: krijon bazën edhe për efektin e produkteve të tjera. Nuk është çudi, sepse përmban qindra substanca të dobishme, të cilat bëjnë që eksperiencat me produktet të jenë pozitive - qoftë fjala për macet, qentë apo për bimët - dr. László Jakab çdo argument e justifikon me shembuj.

Nga festiviteti nuk mund të mungojë muzika: Lui Lajos Túri dhe kori i fëmijëve që e shoqëron atë, këndojnë në mënyrë të mrekullueshme Natën e qetë, më pas "Tre tenorët" **Tibor Éliás, Lajos Túri dhe Miklós Berkics** paraqesin programin e shkruajtur për këtë rast.

Rradhën e kanë kualifikimet: duartrokitje të gjata përshëndesin rezultatet më të mira. Ndoshta fjalët e **Tibor Lapiczit** - Soaring menaxher tregojnë më mirë atë, se çfarë ndjejnë, ata që qëndrojnë në podium: " Ia dimë për nder Foreverit, që mësuam se: ka jetë më të bukur, më të mirë, ekziston një botë më e sigurt. Kurrë nuk ka patur aq njerëz sa tani, që do ta dëshmonin këtë!"

Interpretimi i **Károly Nyárit** dhe vajzave të tij: **Edit dhe Alíz** e shtuan shkëlqimin e këtij evenimenti, më pas József Baranyi me bashkëshorten japin mendimet e tyre për drejtimin dhe shpirtin e skuadrës.

"Kur u lidhe me ne, more një nga vendimet më të mira të jetës tënde" - e fillon menaxheri **József Baranyi**, sipas të cilit elementi më i rëndësishëm i drejtuesit të mirë është integriteti, i cili do të thotë, që është i besueshëm, njerëzit ndjekin atë si person, për atë çfarë ka arritur dhe ka bërë për ata.

„Bashkpuntorët në fillim duaji, e më pas drejtoi ata, në këtë mënyrë do të marrësh respektin e vërtetë. Një drejtues duhet të jetë i vendosur, e di, se nga duhet drejtuar grupi! Sa më lart të ngrihet, aq më të lehtë do ta ketë punën. Mos harro kurrë, njerëzit e tu janë gjithmonë më të rëndësishëm se ty. Për një drejtues të mirë, grupi mirë i tij është thesari më i çmuar."

„Përse është e rëndësishme, që edhe ti të jesh në Londër?" - pyet e bashkshortja e Józsefit, **Eleonóra Baranyi** - menaxhere."

Sepse një eveniment i tillë e ndryshon jetën tënde. Ne në çdo rast kemi marrë shumë këshilla dhe eksperienca nga drejtuesit tanë më të mirë. Ajo forcë lëvizëse gjigande, e cila depërton gjithandej në këtë kohë, mund të përcaktojë edhe për ty jetën tënde. Të jep vrrull të ri, dhe të ndihmon në atë, që të jesh njeri më i mirë dhe më i suksesshëm. Këto takime janë për ty, dhe çfarë është më e mrekullueshme, që punë më të thjesht se kaq nuk kemi patur kurrë . Tani për në Londër të çojnë tre rrugë: njëra është 1500 pikë, tjetra është Chairman's Bonus, të tretën e jep numri i pikëve të mbledhura nëpërmjet bashkpuntorëve të rinj. Në Londër do të takohen përfaqësues të kulturave të ndryshme nga një numër shtetesh të botës duke përfaqësuar atë interes human, që ëndërroi **Rex Maughani**: të gjithë njerëzit të kenë mundësi të jenë të shëndetshëm, të lumtur dhe të pavarur materialisht."

Mjeku kirurg **Dr. Endre Seres** është i dëgjuar për qëndrim e tij tepër skeptik kur u njoh me Foreverin. Pastaj ashtu si shumë të tjerë, produktet edhe atë e bënë për vete. Bashkshortja e tij **Dr.Katalin Pirkhoffer Dr.Seresné** është mjeke e përgjithshme në Lenti dhe kanë dy fëmijë. Çifti Zafir menaxherë, brenda gjashtëmbëdhjet vjetëve ka marrë pjesë në të gjitha Super Rally-t, Global Rally-t, i kanë realizuar të gjitha sfidat, kështu që me të drejtë janë të frymëzuar për të marrë pjesë në Global Rally-n e rradhës. "Përgatisim plane për atë, që të jemi në vazhdimësi gjithnjë e më të mirë" - thonë ata. Në fund eksperiencat e Hawaiit ishin për ta "frenetike", siç thonë, ju pëlqen ajo, që mbetet karakteri familjar, pavarësisht se sa i madh është një takim. Çfarë dhe si duhet të veprojë një ndërtues rrjeti, që të mund të bëhet pjesë e kësaj bashkëjetese? Aktivizim, numri i duhur i pikëve, parimet etike: çifti bën të njohura kriteret, dhe thotë edhe atë, se kush ju përmbahet atyre, çfarë shpërblimi mund të llogarisë. Çeku i bonusit, udhëtime me avion, hotelet, ushqimi, para xhepi, shpenzime... ky është ai kremi në tortë, për të cilin lidhen aq shumë tek firma Forever.

„Krahaso planet e tua me ato të firmës, nuk duhet asgjë e veçantë, vetëm vër atje të tuat: çdo muaj fluturo më shumë se vetvetja!" - thotë Endre Seressi, sipas të cilit ja vlen të luftosh, sepse në një Global Rally presidenti i firmës bën bilancin e vitit të shkuar, parapërgatit të atij që vjen, prezanton produktet e reja, mund të dëgjojmë leksione të rëndësishme marketingu, mund të kesh takime vendimtare dhe sigurisht kjo i bën mirë edhe gjendjes shpirtërore të skuadrës.

„Këtë duhet ta përjetosh, se ndryshe nuk mund ta kuptosh" - shton ai. "Një eveniment me përmasa të mëdha, ku është kënaqësi të ndjesh kujdesin dhe ku mund të krenohesh me

ata, të cilët edhe atje dinë të jenë më të mirët" - shton Katalina. "Ki një objektiv të vërtetë që të shtrëngon fytin! Duhet të besosh në aftësitë dhe në veten tënde. Drejto dhe dirigjo, ji ti ai që drejton të tjerët! Ndjenjë, përjetim, dhe bota do të ndryshojë, të gjitha do të jenë të tuat"!

Me ngjitjen në skenë të Safir menaxherit **József Szabó** gjallërohet e gjithë historia e Foreverit të Hungarisë. Shohim para nesh themeluesin e këtushëm, i cili ka përshkuar shumë herë distancën Debrecen-Frankfurt: çau rrugën para nesh tetëmbëdhjet vjet më parë. Ndërsa tani:" Arrita në atë pjesë të jetës, ku mund të bëjë një jetë cilësore. Guxoni të besoni, që biznesi funksionon edhe për ju! Nuk ka rëndësi sa di për të, por nëse je i frymëzuar, do të dish ta shpjegosh veten tek të tjerët - ashtu siç ndodhi dikur me mua. Mos beso, që me çdo kusht duhet të shesësh çdo gjë - në rradhë të parë ky biznes nuk flet për këtë, por për zhvillimin e personalitetit tënd, si shpërblim i të cilit vjen suksesi. Gjithmonë ndeshesh me mendime të gabuara, dhe nëse ka patur dikush dyshime, ai kam qënë unë. Çdo ditë bëj detyrën tënde me përpjekje serioze, dhe do të arrish një ndryshim të vërtetë. Më kot e ke drejtuesin e mirë, punën e përditëshme ti duhet ta bësh vetë. Pyetja e vetme është: sa besojnë njerëzit tek ti, në se ja vlen ti hyjnë kësaj rruge. Brenda tetëmbëdhjet vjetëve u rrit një gjeneratë e re. Ka pak njerëz, të cilëve nuk ju intereson shëndeti dhe portofoli, pra nëse nuk e pranojnë, atë që ju thua, ajo prandaj ndodh, sepse nuk di të komunikosh mirë me njerëzit. Merre shkopin e stafetës, sepse kjo flet për jetën tënde! Bëje rrugën deri në fund, le të kushtojë, sa të kushtojë! Nëse ka nevojë për ndryshim, ndrysho, ose qëndro aty, ku je sot - ndonëse mund të arrish kudo, mua mund të më besosh. Në fillim nuk kisha besim, pastaj kjo gjë depërtoi brenda meje, dhe sot nuk mund dhe nuk dua të çlirohem prej saj."

OPATIJA TETOR 2013

Success Day

ÇDO DATË DITËLINDJE ËSHTË NJË RAST I MIRË PËR TË FESTUAR. NË TETOR 2013 U PËRKUJTUA 14 VJETORI I HAPJES TË ZYRËS TË FLP KROACI.

Në Opatija, në sallën madhështore të Hotel Adriatikut, gjithshka ndriçonte si për festë. Mbas fikjes të dritave dhe ndezjes të dritave me rreze lazer filloi kjo ditë feste. Drejtues të programit ishin **Sonja dhe Zlatko Jurović** - soaring menaxherë, të cilët falnderuan pjesmarrësit, bashkpunëtorët tanë nga e gjithë Kroacia.
Sonja dhe Zlatko i uruan gjithkujt nga ne gëzuar këtë përvjetor, sepse të gjithë si ata që kanë qënë këtu që nga fillimi i kësaj zyre, ashtu edhe ata që janë bashkuar më vonë, kanë bërë shumë për zhvillimin e kësaj firme në gjithë këta vite që kanë kaluar. Faleminderit të gjithëve- ky ishte mesazhi i drejtuesve të programit.

Vajzat valltare të studios **Jastrebarsko** me mësuesen e tyre ish balerinën e Teatrit Kombëtar të Kroacisë – **Svetlana Lukić** na shfaqën vallet „muraközi".

László Molnár – drejtor rajonal i FLP Kroaci na informoi me të rejat më të fundit të firmës. Përgëzoi të gjithë bashkpunëtorët për xhiron e realizuar. Ky është sukses i të gjithëve sepse është arritur me punën e të gjithëve. Pas kemi lënë suksesin e Holiday Rally në Opatija, ndërsa përpara kemi Rally-in Global të Londrës, Ditën e Suksesit të përbashkët me Slloveninë, trainimet Sonya në zyrat e Zagrebit dhe të Rjekës. Po kështu për programet Turbo Start dhe trainimet e menaxherëve që do të zhvillohen dy herë në vit. Për ta bërë më të lehtë punën e bashkpunëtorëve tanë, kemi filluar një projekt të ri, në kuadrin e të cilit po përgatiten materiale leksionesh zanore për teknikën e ndërtimit të rrjeteve. Pastaj László Molnár thirri në skenë miqtë tanë nga Hungaria **Ágnes Krizsó, Dr Sándor Milesz dhe Péter Lenkey** që uruan përvjetorin dhe përgëzuan për sukseset e arritura. Dr Milesz bëri të njohur rritjen e xhiros nga FLP Kroaci, duke u bërë kështu pararoja e rajonit tonë. Bashkpunëtorëve ju uroi suksese edhe më të larta. Kroacia është prova për mundësitë e zhvillimit, kun ë dy vitet e fundit ka arritur rezultate mahnitëse. Dhe si mund të bëhemi edhe më të mirë? Për këtë na jep këshillat e tij drejtori i përgjithshëm i rajonit.

Menaxheri i përgjithshëm i rajonit Péter Lenkey pas urimit për përvjetorin , shprehu gjithashtu vlerësimin e tij për rezultatet e arritura. Ishte shumë i gëzuar që mundi të ishte me ne në këtë ditë të shënuar dhe shprehu shpresën se këto suksese do të jenë edhe më tej në ngjitje. Ágnes Krizsó ju drejtua bashkpunëtorëve të Kroacisë në mënyrë prekëse. Me vendin tonë e lidhin ndjenja të thella. Ajo e ka nisur rrugën e saj duke ngritur një pjesë të madhe të rrjetit të saj me Kroacinë. Me bashkpunëtorët e FLP të Kroacisë ajo ndezi qirinjtë tortës të ditëlindjes të FLP Kroaci.

Dr. Ivan Bubić – menaxher, mbajti leksionin për Aloe verën. Mjekët kurojnë pasojat e sëmundjeve, mjeku mediokr kuron vetëm para pasojave të rënda, ndërsa mjeku i dalluar parandalon të keqen – me këto fjalë e filloi Dr Bubić. Në pjesën e parë të leksionit mësuam shumë për një nga pjesët më të rëndësishme të trupit tonë, për sistemin e zorrëve, funksionimin, problemet dhe pasojat e tyre. Pastaj foli për rëndësinë e dietës për vlerat e pH ideal, dhe më në fund për atë se si mund të ndihmojë aloe vera për një mënyrë jetese të mirë.
Sinergjija e brezave ishte titulli i leksionit të veçantë të **Andrea Žantev**. Andrea na shpjegoi se si i trajton mardhëniet në krizë midis brezave, si mund të forcojë sinergjinë e frymës të grupit, punën e përbashkët dhe mardhëniet midis njerzve. Me qënë se MLM në fakt është punë me njerzit, duhet të njohim karakteristikat e brezave të ndryshëm, që të mund ta forcojmë skuadrën tonë, duke e bërë më mirë punën tonë. Leksioni i Andreas nxit këdo për të menduar mirë.

Prezantimi i koleksionit Sonya filloi me një film instruktues. **Snježana Beloša dhe Martina Štajdohar** në leksionin e tyre folën për makiazhin, për mënyrën e përdorimit dhe kombinimin e ngjyrave – një punë e vërtetë në grup. Sipas premtimit të tyre ato do të zhvillojnë leksione edhe në zagreb e Rjeka. Ndjekin arritjet e reja, na mësojnë dhe na informojnë për produktet e reja. Falnderojmë menaxheret tona për leksionin e tyre dinamik!

Në FLP e Kroacisë rritja e sukseshme e xhiros ka ecur nga muaji në muaj. Në Ditën e Suksesit u falnderuan gjithashtu bashkpunëtorët e kualifikuar. László Molnár dhe Dr Sándor Milesz, u dorëzuan distiktivet Supervizorëve. Vetëm në 3 muajt e fundit ishin 39 vetë që arritën këtë nivel. Pastaj vazhduan Asistent Menaxherët dhe Menaxherët. Dymbëdhjetë çifte që nuk mund ta fshehin gëzimin: me disa fjalë ata shprehë falnderimin e tyre për firmën, për sponsorit e tyre, por edhe për skuadrën e bashkpunëtorëve që i ka mbështetur. Me të kualifikuarit u gëzuam të gjithë bashkë.

Në fund të pjesës së parë, dhanë përsëri shfaqje valltarët e studios të Jastrebaesko me pjesën muzikore me titull Chicago.

Mbas pushimit Péter Lenkey me demostrim me lazer na prezantoi firmën, zhvillimin e saj në rajon dhe në botë, rritjen e të ardhurave dhe planin e shkëlqyer të marketingut të saj. Na tregoi për modernizimin e përpunimit dhe furnizimit, duke na njohur edhe me qëndrën e re të furnizimit, Forever Direct në Hollandë, që shërben si bazë shpërndarje për Europën dhe të Azinë.FLP është një firmë e tillë që tregon kujdes për ruajtjen e mjedisit dhe për atë që produktet të mos i testojë tek kafshët. Firma disponon gati të gjitha dëshmitë e sigurimit të cilësisë. Gjërat e mëdha gjithmonë janë të thjeshta – theksoi Péter Lenkey, i cili edhe një herë përshëndeti FLP e Kroacisë, duke i urur edhe mëtej vitet ë sukseshme.

Damir Parac dhe bashkshortja e tij, **Dijana** janë menaxher të sapo kualifikuar. Në fillim të leksionit të tyre, flasin për atë se si e kanë kaluar jetën para angazhimit me FLP, kur si sipërmarrës kërkonin të siguronin mirëqënien nëpërmjet një pune të fortë çdo ditë. Pastaj Damir flet për njohjen me FLP dhe me sponsorin e tyre dhe për sukseset që nuk i priste. Sipas tij, për ta ky është vetëm fillimi. Falnderoi sponsorin dhe skuadrën e tij. Damirin dhe Dijanen i shohim në skenë plotësisht të sigurtë, sepse rrezatojnë optimizëm dhe kanë dëshira për më shumë. Sukseset e tyre na gëzojnë!

Pastaj vazhdon dorëzimi i çmimeve. László Molnár dhe Péter Lenkey përgëzojnë fituesit e stimulit të autoveturës, menaxherët Eagle dhe dhe anëtarët e Klubit të Conquistadorëve. Këta janë bashkpunëtorët më të sukseshëm, të gjithë janë modele. Ata i karakterizon konkurenca pozitive, buzëqeshja, nxitja dhe fryma e grupit.

Sipas fjalëve të menaxherit të ri **Stjepan Beloša**, midis nesh nuk ka ardhur thjesht për arsye materiale, sepse edhe më parë këto i ka patur. Megjithatë puna e FLP për të do të thoshte sfidë. U lidh me Foreverin dhe brënda një kohe rekord „prodhoi" disa menaxherë në thellësi. Ka zhvilluar metoda të tilla pune që i ka vënë të gjithë në lëvizje. Në leksionin e tij na foli edhe për atë se si funksionon puna e tij. Duahet mësuar dhe ndjekur kështillën-pastër dhe thjeshtë. I përgëzojmë Snježanán és Stjepanin për suksesin e arritur!

Edhe bashkpunëtorëve të rinj iu dorëzuan distiktivët e shqiponjës. Shpresojmë që leksionet e sotme ti kenë nxitur ata që të ngjiten sa më shpejt në skenë, por në shkallë më të larta kualifikimi. I përgëzojmë ata për startin e sukseshëm.
Në mbyllje na frymëzoi me leksionin e saj **Jadranka Kraljić-Pavletić** - Senior menaxhere. Dëgjuam histori të nxjerra nga jeta, dëgjuam përvojën e një njeriu që kurrë nuk rri si ujë i vakët, të pret duke qeshur, të jep mbështetje dhe nxitje, gjë që është veti vetëm e drejtuesve të vërtetë. Me leksionin e Jadrankas qeshëm shumë por na futi edhe në mendime. Na tregoi pse prej vitesh vazhdon të jetë në krye. Faleminderit Jadranka, me buzëqeshjen tënde na ke infektuar!

Pas leksionit të Jadrankes, drejtori László Molnár thirri në skenë drejtuesit e programit dhe lektorët e kësaj dite suksesi, duke i falnderuar ata për drejtimin e programit dhe për leksionet e shkëlqyera. Dita e ardhshme e Suksesit do të jetë më 15 mars në Opatija. Deri atëhere, le të mësojmë , të ecim përpara dhe të gjejmë bashkpunëtorë të sukseshëm! Edhe një herë gëzuar ditëlindjen FLP e Kroacisë!

dr. László Molnár
drejtor

Vital[5]™

Advanced Nutrition Made Simple

TË ZGJIDHIM ENIGMËN E BOTËS TË PLOTËSUESVE DIETIKË!

Të prezantojmë paketën e re të Foreverit Vital[5].

Kutia përmban produktet e mëposhtëm:
4 copë Forever Aloe Vera Gel
1 copë Forever Active Probiotic
1 copë ARGI+
1 copë Forever Arctic Sea
1 copë Forever Daily

PLUS:

1 lugë mase për ARGI+
Materiale prezantimi
të Vital[5]

Tashmë i keni njohur vetitë e shkëlqyera të Forever Aloe Vera Gel, ARGI+, Forever Daily, Forever Arctic Sea dhe Forever Active Probiotic. Tashmë këto produkte i kemi paketuar në një pako, që me çmim të favorshëm dhe me bonusin e një pike të mbrijnë tek ju. Kjo ju jep një mundësi të shkëlqyer, për një prezantim të thjeshtë të produkteve që ndihmojnë në ushqyerjen e duhur. Vital[5] zgjidh enigmën e botës të plotësuesve dietikë.

Në Europë fillon nga një shkurti 2014.

Vlera e pikëve:

1cc

Shtroji vetes pyetjen kush është jetike për ty?

Vital5 ndihmon jo vetëm për zgjidhjen e enigmës të botës të plotësuesve dietikë, por edhe asaj të ndërtimit të biznesit. Pse? Sepse çdo pako e veçantë e Vital5 do të thotë 1CC! Si mund ta praktikoni këtë në rrjetin tuaj? Merr 2 pako, njërën përdore për vete, tjetrën ndaje me të tjerët!

Sistemin tretës „na i kanë planifikuar" për atë që të trasmetojë në mënyrë të efektshme lëndët ushqyese nëpërmjet indeve të organeve më të rëndësishme të trupit tek qelizat e tij. Lëndët ushqyese që vijnë nga ushqimet dhe nga plotësuesit dietikë mbrrijnë tek organizmi ynë, dhe sistemi tretës ndihmon që ato të arrijnë në çdo ind dhe qelizë, si dhe të largojë prej andej mbetjet. Rezultati është një sistem tretës që funksionon mirë, që siguron për ne një shëndet optimal, vitalitet, energji mendore e shpirtërore. Forever Living ju prezanton paketën Vital5, që mbështet sistemin tonë të thithjes të ushqimeve..

TURBO
START
profin
Bazat e profesionit MLM

NË RUBRIKËN TONE TË RE, NGA MUAJI NË MUAJ LEKTORËT E SERIES TË CD "TURBO STAR", DO TË NDAJNË ME NE MENDIMET E TYRE PËR MATERIALET ZANORE TË PËRGATITURA PREJ TYRE. SI FILLIM DIAMANT MENAXHERI MIKLÓS BERKICS FLET PËR RËNDËSINË E FILLIMIT TË SUKSESHËM, PËR SERINE I-II TË CD "TURBO STAR

Në qoftë se duam të flasim për ndërtim rrjeti të sukseshëm, atëhere kemi tre tema kryesore që duhen menduar. Që të kemi një rrjet të madh dhe të sukseshëm, patjetër ka nevojë për për materiale të tilla zanore, që I përgjigjen zhvillimit të personalitetit, mbasi dihet: aq do ta kemi rrjetin sa është edhe personaliteti ynë. Në qoftë se për diçka, ndërtimi i rrjetit "nuk do të eci", atëhere të ndryshojmë personalitetin tone se do të ndryshojë edhe rezultati! Tema e dytë për të cilën janë të rëndësishme këto materiale zanore, janë historitë e suksesit motivues, sepse nga shembujve I të tjerëve mund të frymëzohemi edhe ne. Edhe në qoftë se nuk kemi arritur nivelet e tyre të biznesit, që I kemi vënë si objektiv para vetes, atëhere historitë e tyre mund të na përforcojnë qëndresën.
Megjithatë pjesa më e rëndësishme mbetet pjesa mbi bazat e profesionit MLM; materialet zanore të series të CD "Turbo Start", me ndihmën e të cilave ndërtojmë biznesin tone.
Kur dikush i futet kësaj sipërmarrje, e bën për atë që të fitojë para dhe të arrijë suksesin mundësisht brënda kohës të parashikuar. Prandaj kur dikush ia nis kësaj, për të qënë i sukseshëm duhet tia fillojë duke u furnizuar mundësisht me materialet-turbo. Në ndihmë të kësaj kemi përgatitur serine e materialeve më të mira të atyre që jo vetëm flasin në teori, që japin intervista në gazette, që përgatisin CD, por janë rezultativ edhe në xhiron e shitjeve, në rritjen e shkallëve të marketingut por edhe në të ardhurat që fitojnë.
Kemi përgatitur 12 CD. Këto 12 CD na tregojnë për atë se si kushdo që i futet rrugës MLM në Forever, ai mund të ndërtojë një biznes të sukseshëm. Por nuk mjafton vetëm ti blesh apo ti dëgjosh vetëm një here këto CD, sepse me kalimin e kohës ndryshon edhe mënura e të menduarit dhe personaliteti ynë: po atë material mbas disa muajsh mund ta kuptojmë ndryshe.
Në pjesën e fillimit të series janës CD e Turbo Start I-rë dhe II-të. Në këto dy CD kam dashur të përgatit materiale të tilla zanore gjithpërfshirse, ku ata që hyjnë të rinj në biznesin tone të sqarohen keqkuptimet, që mund të kenë për MLM, dhe largimin e atyre mendimeve të gabuara se profesionin tone e rrethojnë rastësitë.
Në zbërthim të kësaj kam sqaruar dhjetë hapa se çfarë dhe si duhet të veprojmë në fillim në këtë punë. Në pjesën e dytë se me çfarë gabimesh një rrjet tashmë të ngritur edhe mund ta prishim.

Dihet se dikush që fillon të punojë si rrjetndërtues, ai nuk ka kryer paraprakisht shkolla të MLM, nuk ka kryer kurse të MLM, por vjen nga një profesion tjetër dhe për të bota e merketingut në rrjet është diçka krejt e re. Në qoftë se do të dallohesh dhe do të njohësh mire një profesion, atëhere prej tij do të mund të fitosh para. Sipas përvojës sime CD e Turbo Start I-rë blehen në magazine 2 herë e gjysëm më shumë se CD e pjesës tjetër, kur fjala është për dy anë të të njëjtës gjë. Kjo është si romanet kriminale ku lexojmë vetëm gjysmën e parë, ndërsa pjesën e dytë ku del se kush e çgroposi nga kopështi qenin e kopshtarit nuk e lexojmë. Për fat të keq kështu ndodh edhe në fusha të tjera të jetës: njerzit i futen diçkaje por nuk e përfundojnë. Fillon të mësosh anglisht, por mbas tre javësh nuk shkon në orën e mësimit. I futesh kurës të rënies në peshë, por ditën e tretë nuk duron më, dhe në orën dhjetë të mbremjes i përvishesh biftekut të viçit. Kështu ndodh edhe me biznesin MLM: njerzit e fillojnë me entusiazëm, por procesin nuk e çojnë deri në fund.
Prandaj këdo e këshilloj ti dëgjojë sistematikisht CD e Turbo Start I dhe II ! Mbaji gjithmonë në makinë serinë e 12 CD, por jo atje ku mbahen dorashkat, por aty ku mund ti dëgjosh vazhdimisht! Ashtu sikurse e konsiderojnë njerzit e zgjuar: rregullat e ndërtimit të biznesit nuk do të na duheshin kur kujtohemi për to, por ashtu sikurse e thonë njerzit më të sukseshëm në këto materiale zanore, dhe ashtu si na i kanë trasmetuar dijet e tyre.

Gjithkujt në të ardhmen i uroj ndërtim rrjeti të sukseshëm, dhe një system marketingu të fuqishëm e që funksionon mire!

Miklós Berkics
Diamant menaxher

NË 2014 NISIM NJË SERI TË RE TRAINIMI!

Le të jeni edhe ju prezent në Sallën Syma, në ditët e Turbo Star, atje ku seria e CD Turbo Start dhe prezantimi dhe kuptimi i materialeve të reja profesional do të mund ti japin një hov të ri punës tuaj!

FOREVER

NJË MLM E VËRTETË

Forever Living Products është krenare për atë që është një nga firmat më të mira të multi-level marketing-ut. Me një investim material minimal sigurohet mundësia, që njeriu duke u mbështetur në forcat e veta, të sigurojë të ardhurat që meriton. Sistemi i krijuar më 1946 nga degë të industrisë të shitjes direkt, u siguron distributorëve të ardhura sipas shitjeve, por nëpërmjet kësaj sigurojnë edhe një rrjet të rëndësishëm shitësish.

Ndonjëherë ata njerëz që nuk dinë shumë për multi-level marketingun, e ngatërrojnë atë me skemat piramidale.Në skemat piramidale, njerzit u marrin paret njerzve të tjerë poshtë tyre, që paguajnë shuma të ndryshme dhe këto skema praktikisht në çdo vend të botës konsiderohen veprimtari ilegale. Që të kuptojmë ndryshimet themelore midis skemave piramidale ilegale dhe sistemit legal MLM, sot kjo distributorëve të mundshëm u shpjegohet shumë thjeshtë. Së pari për këtë le të shohim karakterin e skemave piramidale.

Në skemat piramidale është i nevojshëm një investim fillestar, që është i nevojshëm për të zënë një pozicion fillestar. Atyre që fillojnë u thuhet se nuk duhet të shesin asgjë, vetëm të sjellin të tjerë, nga të cilët pastaj do të marrin një përqindje. Edhe në qoftë se në skemë kemi ndonjë produkt, theksi nuk vihet në atë që produkti të mbrrijë tek konsumatori fundor. Rezultat i këtij sistemi, është ajo që brënda një kohe të shkurtër (në përgjithësi brënda dy vjetëve) e gjithë skema, shthuret dhe rrëzohet e gjitha. Nga ajo përfitojnë vetëm ata njerëz, që e ngritën atë skemë piramidale apo ata që ishin në nivelin e parë. Të tjerë i thonë lamtumirë investimit të tyre.

Kundrejt kësaj, Forever Living si një MLM e vërtetë ofron sa më poshtë: Nuk ka nevojë për investim shumash të mëdha, distributorët paguajnë vetëm për produktet që blejnë. Esenca është shitje e produkteve dhe për këtë merr fitimin. Kur ne sponsorizojmë dikë, në thelb kjo nuk do të thotë se ne blejmë një pozicion të caktuar në planin e marketingut, por ne sigurojmë klientë, që përdorin vetë produktet dhe i popullarizojnë ato. Si rezultat i kësaj, biznesi ynë rritet vazhdimisht, dhe qëndron në baza stabël. Kushdo që punon në FLP siguron të ardhura, por më kryesorja është ajo që në radhë të parë të ndihmosh të tjerët për të siguruar të ardhura.

Prandaj në më të afërtën, në qoftë se dikush nuk kupton cili është ndryshimi midis FLP dhe skemave piramidale, ndihmojini ata ta kuptojnë! Sistemi i vërtetë MLM siguron në mënyrën më të thjeshtë që produktet cilësore të shkojnë nga prodhuesi tek përdoruesi. Sistemi MLM është një nga sistemet e biznesit që po zhvillohet më shpejt sot në botë, ku miliona njerëz ndihmojnë në çdo skaj të botës, për të arritur një mbështetje të sigurtë materiale, që as do të kishin guxuar ta endërronin. Prandaj të jeni krenar për sistemin MLM dhe në mënyrë të veçantë për FLP, firmën më të mrekullueshme të kësaj dege të industrisë!

PLANI PROGRAMIT DHE TRAINIMEVE TË FLP PËR 2014

Janar	**18.** Success Day Ljubljana	**25.** Success Day Budapest, Salla SYMA		**26.** Success Day Beograd
Shkurt	**15-16.** Trainim i Diamantëve nga Miklós Berkics, Budapest, Salla SYMA			
Mars	**22.** Success Day Budapest Salla SYMA	**15.** Success Day Opatija	**30.** Success Day Beograd	
Prill	**6.** Dita Turbo Start, Budapest, salla SYMA	**19.** Success Day Maribor	**27 prill- 5 maj,** Global Rally, Londër	
Maj	**10** Success Day Zagre **10.** Success Day Sarajevo	**17.** Success Day Budapest Salla SYMA	**18.** Dita e V. e Shëndetit, Budapest, salla SYMA **18.** Success Day Beograd	**19-26.** GO DIAMOND Turqi
Qershor	**7.** Turbo Start në Slloveni	**14-15.** Trainim i Diamantëve nga Miklós Berkics, Budapest, salla SYMA	**22.** Success Day Beograd	
Korrik	**19.** Success Day Budapest Salla SYMA			
Gusht	**2.** Dita Turbo Start, Budapest, salla SYMA			
Shtator	**13.** Success Day Budapest Salla SYMA	**21.** Success Day Beograd	**24-29.** Eagle Manager Retreat Lake Tahoe	
Tetor	**3-4.** Holiday Rally Opatija	**11.** Trainim i Diamantëve nga Miklós Berkics, Budapest, salla SYMA	**25.** Success Day Opatija	
Nëntor	**8.** Success Day Bijeljina	**15.** Success Day Budapest Salla SYMA	**22.** Success Day Ljubljana	**30.** Success Day Beograd
Dhjetor	**6.** Dita Turbo Start, salla SYMA			

NIVELIN E SENIOR MENAXHERIT E ARRITËN

Izabella Szücs Zachár dhe Zsolt Zachár
(sponsor: Éva Budai-Schwarcz)

BESIMI realitet i gjërave të shpresuara, bindje për gjërat që nuk i ke parë.

NIVELIN E MENAXHERIT E ARRITËN

Krisztina Kovács-Burák dhe Attila Burak
(sponsor: Mihályné Kovács dhe Mihály Kovács)

Suksesi është: disiplinë dhe objektiv. Disiplinë dhe punë. Zhvillim dhe këmbngulje. Fokusim tek Foreveri. Pastër dhe thjeshtë.

Dr Attila Schoffer
(sponsor: Izabella Szücs Zachár dhe Zsolt Zachár)

„Në Sport dhe në jetë duhet përqëndrim, për atë që dëshiron të arrish!"

Andrew Matthews

Orsolya Samák
(sponsor: Timea Kubisci)

„Forca gjithmonë qëndron tek skuadra. Këtu veten e ndjej mirë dhe mund të zgjedh me cilin të bashkëpunoj"

Szilvia Virányi
(sponsor: Krisztina Király)

„Mos ki frikë nga ajo, se kurd o të mbarojë jeta, por nga ajo që kurrë nuk do ta kesh filluar"

John Henry Newman

NIVELIN E SUPERVISOR-I E ARRITËN

Bacsáné Nagy Erika
Balogh Edina
Barišić Živana
Begonja Biserka
Borsics László & Gosztonyi Anita
Bódi László
Csontos Karola
Csorbáné Rácz Mónika
Czinege Attila
Daku Henriett
Denović Radoje
Dr. Vitányi Györgyi
Dunavölgyi Mihályné
Erdélyi Kornélia
Erdősi Béla
Ferencz Tímea & Vass Csaba
Fodor Edit
György Sándorné & György Sándor
Hajdu Eszter Ildikó
Halmai József & Dr. Czifra Gabriella
Hus Sándor Istvánné & Hus Sándor István
Husz László & Husz Lászlóné
Jovan Péter & Jovanné Császár Edit
Kériné Lukács Piroska & Kéri János
Kecan Mira & Kecan Nebojša
Kecse-Nagy Sándor
& Kecse-Nagyné Bánszki Zsuzsanna
Kiss Zoltán
Kitanović Nenad & Kitanović Dušanka
Kovács Gézáné & Kovács Géza
Kovácsné Sohár Krisztina & Kovács Sándor
Kovačić Danica
Kropej Irma & Kropej Silvester
Kulcsár László Dávid
Kun Ildikó
Lukács Ferenc
Lőrinczyné Seres Andrea & Lőrinczy Balázs
Mészárosné Dr. Herczegh Anna
Mijatov Nina & Mijatov Srđan
Némedi Erzsébet
Nagy Elemér Sándor
Nyilas-Tóth Ibolya & Nyilas József
Petković Vesna
Réti Józsefné & Réti József
Székely Károlyné
Szénai Gergő
Szénai Boglárka
Szabó Emma
Szatmári Zsuzsanna & Petrezselyem Sándor
Szegi Márta
Tothova Helena
Tóth Gergő
Tóthné Szabó Andrea & Tóth György
Vargova Katarina
Ónodiné Szuhár Edina

NIVELIN E ASSISTANT MANAGER-IT E ARRITËN

Ferenczi Gabriella
Kordova Mgr. Edita & Korda Jan
Petrovics Anett & Petrovics Brunó
Tengerdi Gábor Ferenc & Bordács Barbara
Tomović Tatjana
Tomović Lovro
Tóth Jolán & Sebők Péter

CONQUISTADOR CLUB

11. 2013. DHJETË DISTRIBUTORËT MË TË SUKSESSHËM NË BAZË TË PIKËVE PERSONALE DHE TË NON-MENAXHERIT

HUNGARIA

1. **Zachár-Szűcs Izabella & Zachár Zsolt**
2. **Varga Géza & Vargáné Dr. Juronics Ilona**
3. **Dr. Schoffer Attila**
4. Varga Róbert & Varga-Hortobágyi Tímea
5. Keneseiné Szűcs Annamária
6. Dobai Lászlóné & Dobai László
7. Kovács Mihályné & Kovács Mihály
8. Haim Józsefné & Haim József
9. Burák Attila & Burák-Kovács Krisztina
10. Kordaova Kinga Mgr.

KROACI

1. **Alen Lipovac & Dolores Lipovac**
2. **Andrea Žantev**
3. **Sonja Jurović & Zlatko Jurović**

SLLOVENIA

1. **Jožica Arbeiter & Dr. Miran Arbeiter**

FITUESIT E PROGRAMIT MOTIVUES TË BLERJES SË MAKINËS

NIVELI 1-RË
Jožica Arbeiter & Dr. Miran Arbeiter
Becz Zoltán & Kenesei Zsuzsanna Viktória
Bruckner András & Dr. Samu Terézia
Marija Buruš & Boško Buruš
Csuka György & Dr. Bagoly Ibolya
Davis Erika & Davis Henry
Dr. Dósa Nikolett
Éliás Tibor
Fekete Zsolt & Ruskó Noémi
Ferencz László & Dr. Kézsmárki Virág
Olivia Gajdo
Gecse Andrea
Gombás Csilla Anita & Gombás Attila
Gyurik Erzsébet & Sándor József
Hajcsik Tünde & Láng András
Heinbach József & Dr. Nika Erzsébet
Hertelendy Klára
Rinalda Iskra & Lučano Iskra
Vladimir Jakupak & Nevenka Jakupak
Dragana Janović & Miloš Janović
Juhász Csaba & Bezzeg Enikő
Sonja Jurović & Zlatko Jurović
Dr. Kereszténytyi Albert
Kis-Jakab Árpád & Kis-Jakabné Tóth Ibolya
Dr. Kiss Ferenc & Dr. Nagy Ida
Klaj Ágnes
Manda Korenić & Ecio Korenić
Jadranka Kraljić-Pavletić & Nenad Pavletić
Kúthi Szilárd
Lapicz Tibor & Lapiczné Lenkó Orsolya
Mázás József
Mentesné Tauber Anna & Mentes Gábor
Dr. Molnár László
& Dr. Molnár-Stantić Branka
Muladi Annamária
Nagy Andrea
Nagy Ádám & Nagyné Belényi Brigitta
Vaselije Njegovanović
Dr. Marija Ratković
Dr. Rokonay Adrienne & Dr. Bánhegyi Péter
Sebők Judit
Dr. Seresné Dr. Pirkhoffer Katalin
& Dr. Seres Endre
Dr. Szénai László
& Dr. Szénainé Kovács Gabriella
Tanács Ferenc & Tanács Ferencné
Varga Józsefné
Jozefa Zore
Zsidai Renáta

NIVELI 2-RË
Budai-Schwarcz Éva
Haim Józsefné & Haim József
Kása István & Kása Istvánné
Leveleki Zsolt & Leveleki Anita
Dr. Németh Endre & Lukácsi Ágnes
Orosházi Diána
Siklósné Dr. Révész Edit & Siklós Zoltán
Tihomir Stilin & Maja Stilin
Utasi István & Utasi Anita
Varga Géza & Vargáné Dr. Juronics Ilona

NIVELI 3-RË
Berkics Miklós
Tomislav Brumec & Andreja Brumec
Halmi István & Halminé Mikola Rita
Herman Terézia
Krizsó Ágnes
Stevan Lomjanski
& Veronika Lomjanski
Dr. Milesz Sándor
Szabó József
Tóth Sándor & Vanya Edina
Vágási Aranka & Kovács András
Varga Róbert & Varga-Hortobágyi Tímea

60 CC+

11. 2013. TË KUALIFIKUARIT

Zachár-Szűcs Izabella & Zachár Zsolt
Varga Géza & Vargáné Dr. Juronics Ilona
Dr. Schoffer Attila
Varga Róbert & Varga-Hortobágyi Tímea
Keneseiné Szűcs Annamária
Dobai Lászlóné & Dobai László
Dr. Kolonics Judit
Kovács Mihályné & Kovács Mihály
Haim Józsefné & Haim József
Dr. Seresné Dr. Pirkhoffer Katalin & Dr. Seres Endre
Meggyesi Imre & Meggyesiné Kántor Tamara
Burák Attila & Burák-Kovács Krisztina
Éliás Tibor
Kordaova Kinga Mgr.
Lipovac Alen & Lipovac Dolores
Csuka György & Dr. Bagoly Ibolya
Muladi Annamária
Hajcsik Tünde & Láng András
Brumec Tomislav & Brumec Andreja
Fekete Zsolt & Ruskó Noémi
Žantev Andrea
Rajnai Éva & Grausz András
Tanács Ferenc & Tanács Ferencné
Dr. Rédeiné Dr. Szűcs Mária & Dr. Rédei Károly
Király Krisztina
Jurović Sonja & Jurović Zlatko
Gulyás Melinda
Hollósy Endre András
Klaj Ágnes
Borbáth Attila & Borbáth Mimóza
Tóth Zoltán & Kiss Barbara
Dr. Szénainé Kovács Gabriella & Dr. Szénai László
Virányi Szilvia
Dr. Fábián Mária
Iskra Rinalda
Lomjanski Stevan & Lomjanski Veronika
Tóth János
Dr. Rokonay Adrienne & Dr. Bánhegyi Péter
Hajdu Ildikó Rózsa & Hajdu Kálmán
Heinbach József & Dr. Nika Erzsébet
Szabó Nikoletta & Szabó György
Gulyka Krisztina
Orbán Tamás
Mázás József
Szolnoki Mónika
Kiss Zoltán & Kissné Szalay Erzsébet
Tóth Tamás & Bostyai Emìlia
Arbeiter Jožica & Dr. Arbeiter Miran
Ferencz László & Dr. Kézsmárki Virág
Nagy Ádám & Nagyné Belényi Brigitta

Bli në kohë biletën që është për vendin më të mirë dhe do të japim si dhuratë një CD, e cila përmban materialin zanor të trajnimit Diamant të qershorit 2013, mes shumë të tjerave leksionin e Bodo Schäfer !

SIGURO VENDIN TËND

NË TRAJNIMIN DIAMANT TË SHKURTIT 2014!

DEKLARIM MISIONI

Jemi angazhuar për jetë në sipërmarrjen më të shkëlqyer të MLM, në Forever Living Products.
Çdo ditë punojmë me të gjitha forcat tona, me njohuritë tona më të mira, që lajmin e mirë tua trasmetojmë sa më shumë njerzve, se në Hungari kjo është mundësia më e bukur dhe më e mirë për sigurimin e mënyrës të jetesës të cilësisësisë më të lartë. Ndihmojmë me shpirt progresin dhe zhvillimin e çdo njeriu, çdo bashkpunëtori të ri që punon me ne.
Kemi besim se me misionin tonë kontribuojmë për familjen tonë, për rrethin ku jetojmë, dhe për ecjen më përpara të atdheut tonë!

János Székely dhe Dóra Juhász
Senior menaxherë

180 MINUTA QË TË NDRYSHOJNË JETËN

NË SHKURT 2014 VJEN NË HUNGARI SMILJAN MORI NGA SLLOVENIA, QË JO VETËM TË NA TREGOJË SEKRETET E SUKSESIT TË TIJ, POR EDHE „TË PROGRAMOJË PËR SUKSES" MËNYRËN E TË MENDUARIT TË PJESMARRËSVE NË TRAINIMIN E DIAMANTËVE. NË KËTË INTERVISTË NA JEP PARAPRAKISHT MESAZHIN E TIJ.

Keni mbajtur herë tjetër leksione në Hungari?
Jam jashtzakonisht i emocionuar, që më kanë ftuar në Hungari për të mbajtur leksion për distributorët e Hungarisë dhe të rajonit. Aty kam qënë disa vite më parë, por leksione nuk kam mbajtur. Në një seminar në Ukrainë, ishte edhe një lektor nga rajoni i Hungarisë, por këtu në Budapest me FLP, në fakt ky është rasti i parë, por jam i sigurtë që nuk do të jetë leksioni i fundit.

Në verën e 2013 në trainimin GO Diamond të zhvilluar në Varna, 140 hungarezë patën mundësinë të dëgjonin leksionin tuaj. Çfarë përvoje ke siguruar lidhur me ata që punojnë me MLM? Si bashkëpunon me ta?
Më duhet të them që më ka habitur shumë energjia dhe frymëzimi që kam parë në këtë trainim. Mundet kjo të jetë edhe për shkak të drejtuesve, por ishte një përshtypje e jashtzakonshme, se çfarë angazhimi demostronin pjesmarrësit ndaj firmës dhe produkteve të saj. Përveç kësaj pash se këta distributorë ishin nga distributorët e veshur më mirë nga distributorët që kam takuar diku tjetër. Mezi pres që të takohem përsëri me ta.

A mund të na jepni një mendim tuajin për situatën ekonomike financiare të pesë vjetëve të shkuara në Europën Qëndrore-Lindore?
Që të jem i sinqertë, me situatën ekonomike financiare aktuale nuk jam angazhuar, sepse e gjithë kjo vetëm se më trazon mendimet dhe të ardhmen time. Fokusohem në endërrat dhe objektivat e mija, si dhe me atë se si mund të ndihmohen miliona njerzit në mbarë botën. Mendimi im është se e ashtuquajtura „krizë" është vetëm një produkt i medias. Mos shiko televizorin, dhe do të kesh mendime më të mira për situatën. Në qoftë se ke pikpamjet e duhura, nuk ka rëndësi çfarë situate ekonomike është, dhe biznesi yt do të rritet. Për këtë do të flas shumë në leksionin tim në shkurt, sepse sot një kjo është një nga shkaqet e asaj pse njerzit apo firmat nuk arrijnë rezultatin që do të donin. Në fakt kriza është një mundësi për drejtuesit.

Sa të mëdha i shikon mundësitë e ndërtimit të rrjetit?
Sipas mendimit tim Network Marketing, është një nga modelet më të mira të biznesit në botë, dhe ka akoma hapësirë ku mund të rritet. Ky model biznesi, sjell shumë miliona, dhe ka mundësi të ndryshojë të ardhmen ekonomike të një vendi.

Në zhvillimin e personalitetit tuaj dhe zgjerimin e njohurive tuaja kush ka ndikuar më shumë?
Ka patur shumë njerëz që kanë ndikuar tek unë dhe në zhvillimin e personalitetit tim. Kujtoj këtu Susan Jeffers, me librin „Feel the fear… and do it away" (Ndjeje dhe …largoje frikën. Kjo vepër më ka sjellë ndryshim idesh në jetën time. Përveç kësaj ka shumë autorë të famshëm që kanë ndikuar në mënyrën e të menduarit dhe në zhvillimin tim si: Napoleon Hill, Dale Carnegie, Jim Rohn, Tony Robbins dhe shumë të tjerë. Në shtëpi në bibliotekën time kam rreth 10 mijë libra dhe shumë materiale audiovizive. Në pesë vitet e shkuara kam lexuar shumë libra shumë studime psikologjike që merren me mendimin pozitiv. Ndërmjet të tjerash edhe për këtë temë do të flas në Budapest, se si mund ti shfrytëzojmë zbulimet më të reja në biznes dhe në jetën tonë private.

Çfarë botimesh apo librash tuajat do tu rekomandonit bashkpunëtorëve distributorë?
Kam shumë libra, por shumica janë në gjuhën sllovene. Vepra ime e parë „Motivation for life", që është botuar edhe në anglisht dhe që u bë bestseller në amazon.com Këtë patjetër do tia rekomandoja gjithkujt.

Çfarë mund të përfitojnë ata distributorë që do të marrin pjesë në Trainimin e Diamantëve të Foreverit të organizuar nga Miklós Berkics në shkurt 2014?
Gjithmonë është e vështirë që njeriu të flasë për vete, por sidoqoftë mund tju premtoj që në fund të trainimit do të thoni, ky ishte seminari më i mirë në jetën time. Ky 180 minutësh që nuk është ndonjë kohë kaq e gjatë, do tju ndryshojë jetën, sepse do të praktikoj shumë metoda të tilla, që ndikojnë direkt në botkuptimin e njerzve dhe u fshijnë atyre pengesat. Ky seminar do tju vlejë shumë para, më besoni se di çfarë flas. Pres shumë, që të takohemi presonalisht!

ALOE day

PODGORICË 30.11.2013

Të mbushur plot energjidhe me shumë bashkpunëtorë të rinj u mblodhëm në hotelin Aurel të Podgoricës, për të qënë pjesë e takimit të paharrueshëm të Aloes.

Me drejtuesin sigurtë të programit tonë, do të kemi avokatin e mirë, por edhe bashkpunëtorin më të mirë të FLP. **Muamer Suljović** na tregon pse u bashkua me firmën tonë dhe sh dhe për mundësitë që ekzistojnë në Malin e Zi për këtë firmë. Në Malin e Zi FLP është futur në rrugën e zhvillimit, dhe këtë nuk e tregojnë vetëm statistikat, por edhe ajo që trainimet tona, vizitohen gjithnjë e më shumë nga shumë bashkpunëtorë të rinj, të cilët kanë ide konkrete për zhvillimin e sipërmarrjes së tyre, të gjithë duan lirinë e veprimit dhe punën e tyre duan ta lidhin me Foreverin. – Të gjithë i presim me dashuri- u shpreh drejtori rajonal i FLP Serbi, **Dr Branislav Rajić**.

Me mënyrën e sotme të jetës intensive, me produkte gjenetike të këqia që të çojnë në stres, janë prezent faktorët e rrezikut të zemrës dhe të sistemit të venave. Në leksionin e saj **Dr Marija Ratković** - zafír menaxhere na prezanton produktet më të mira të FLP që mund të kontribuojnë për një cilësi më të mirë jetese. Ajo zotëron një praktikë të pasur mjekësore por edhe si bashkpunëtore e FLP, dhe ishte një nga mjeket e para të rajonit që vlerësoi produktet e Foreverit dhe e mbështeti maksimalisht atë. Patëm rastin të dëgjonim përvojën e përdoruesve dhe fituam siguri nga përvoja pozitive të vrejtur gjatë përdorimit praktik të këtyre produkteve.

Receta për cilësinë e mirë të jetës nuk fshihet vetëm tek produktet e FLP por edhe tek plani i marketingut të kësaj firme. Është një nga mënyrat e asaj, sesi mund të shmangësh sëmundjen më të madhe të njeriut të sotëm, sëmundjen e kuletës bosh. –Merrni guximin dhe vozitni në ujrat e sipërmarrjes personale, kuptoni frymën e biznesit të Foreverit, bëhuni vizionar të sukseseve të biznesit tuaj privat, ku timonin e karierës tuaj e drejtoni sipas qëllimit tuaj! – na dha si mesazh menaxheri **Boriša Tomić**.

„Në vlerësimin më të lartë të jetës sime, është jeta në FLP" – filloi leksionin e saj, soaring menaxherja **Vesna Kuzmanović** – Mbasi u garantova për forcën e produkteve të FLP, ishte jashtzakonisht e thjeshtë, jo vetëm tua rekomandoja të tjerëve, por të ndaja me ata edhe kënaqsinë për këto produkte. FLP si pozicion kryesor pune…, në fillim nuk e mendova, por pasi u garantova për avantazhet e planit të marketingut, nga ai moment, koha e harxhuar në zyrat e ndërmarrjes shtetërore ishte kohë e humbur kot". Forca e shumëfishimit për të gjithë grupin e bashkpunëtorëve siguron arritjen e objektivave të caktuar – dhe sot kjo është më e lehtë se kurrë ndonjë herë.

Rrjeti i degëve të Forever Living sot është shpërndarë në gjithë botën. Hapat që çojnë në një punë të sukseshme janë shumë të thjeshta: 1. gjej bashkpunëtor të rinj, 2. informoji ata për gjithshka, çfarë ofron Foreveri, 3. plotëso me ta formularin e aplikimit (kontratës), 4. bëjua të mundur atyre që të mbrrijnë tek produktet me çmime më të lira e sa më shpejt sipas planit të marketingut. **Boro Ostojić** – senior menaxheri nga Beogradi ka patur gjithmonë ide të qarta se çfarë pune e sigurtë dhe afatgjatë i duhet për vete dhe për familjen në një firmë të tillë të dalluar. Nëpërmjet FLP, jeta e tij pushoi së qëni një jetë e zymtë, kjo firmë e bëri të mundur për atë një mënyrë jetese, për të cilën 15 vjet më parë mori vendimin më të rëndësishëm.

Përgëzime asistent supervizorëve të sapo kualifikuar, dhe ju urojmë atyre suksese në punën e tyre të mëtejshme! Takimi i ardhshëm i Podgoricës do të jetë më 1 shkurt 2014. Në emër të FLP Podgoricë, ju urojmë të gjithëve krishtlindje të gëzuara dhe një vit të ri të begatë!

Dr. Branislav Rajić
Drejtor i Forever Living Products Beograd

ERIKA TANÁCS SENIOR MENAXHER

Gjithmonë e kam pasur dëshirë, **që shembullin të mund ta çoj më tej**

Sponzor: Beáta Tasnády **Linja e sipërme:** Angelika Szidiropulosz, Annamária Bernát, Diána Orosházi, Dr. Sándor Milesz

Me sa di, "familja" për ty është një koncept kryesor.
ÍPo është e vërtetë, nëse mund të përmblidhet me një fjalë, e gjithë ajo, që për mua ka vlerë, atëhere këtë fjalë do të thosha, e cila ndoshta mund të tingëlloj e pazakontë nga një grua e ndarë me tre fëmijë, ndonëse besova tek martesa, aq sa munda. Prindërit e mi kanë pesëdhjet vjet bashkë, dhe ky afinitet, kujdesi për njëri-tjetrin, forca e premtimit... është për tu marrë shembull. Sot bota jo më kot është aty ku është. Nëse nuk ka forcë solidariteti në komunitetet themelore, atëhere si mund të formonim komunitete në një shoqëri më të zgjeruar apo në punën tonë? Familja për mua është gjithshka, dhe edhe atë ja falenderoj Foreverit, që mund të rrijë në shtëpi dhe të kujdesem për gjyshen time nëntëdhjet e dy vjeçare (sigurisht për këtë më ndihmojnë motra ime Monca si edhe prindërit e mi - *Ferenc Tanács dhe Ferencné Tanács Senior menaxherë - red.)* Nëse do të punoja diku tetë orë, kujt do ti interesonte, se si do ta zgjidhnja? Në një farë mënyre nuk jemi në gjendje të marrim mençurinë, dashurinë dhe forcën natyrore, që gjendet tek të moshuarit. Nuk kalojmë kohë të mjaftueshme me ata, ndërsa kjo është baza e çdo gjëje. Gjatë festave njerëzit kthehen tek vetja, dhe e kuptojnë, çfarë gabimesh bëjnë, por për këtë nuk duhet krishtlindje, që të kuptojmë, se çfarë vlerash duhet të ndjekim.

Ndërtimin e biznesit të Foreverit e fillove si e vetme?
Jo, për këtë 8 vjet më parë, e gjeta këtë mundësi falë Beata Tasnády, dhe asaj i jam mirënjohëse edhe sot. Atëhere këtë biznes e pashë si mjet, si mjet për atë, që të mund të fillojë një jetë të re me fëmijët e mi. Dhe ky biznes na krijoi kushtet materiale. Bleva një shtëpi dhe rrita fëmijët. Sot djali im vazhdon fakultetin e inxhinjerisë mekanike në Universitetin Teknik, dhe krahas saj punon në një fondacion, vajza e mesit mëson në shkollë të mesme me drejtim gjuhë-histori, veç kësaj shkruan novela dhe kërcen, vajza më e vogël mëson gjimnastikën sportive ritmike dhe vizaton bukur. Kështu që jeta ime është e lumtur dhe e ekuilibruar, në pjesën më të madhe të së cilës ja di për nder ndërtimit të rrjetit.

Djali merret me bamirësi, edhe tek prindërit që janë mjekë alternativë ka dyndje njerëzish, edhe ty të pëlqen të japësh. Kjo është diçka që shkon në familje?
Është e sigurt, që dëshira për të ndihmuar, dhe ndjenja sociale gjendet brenda nesh. Unë gjithmonë kam dashur të jem mjeke, gjithmonë vetëm kam dashur t'ju jap njerëzve, por më devijuan nga kjo rrugë dhe së fundi pas rritjes së fëmijëve, këtu në Forever gjeta atë mjedis, ku mund ti realizoj të gjitha ato, për të cilat mund të kem ëndërruar ndonjëherë. U diplomova në fushën e komunikimit, dhe këtë di ta përdor maksimalisht në trajnime, ndërsa ndihma për njerëzit realizohet nëpërmjet produkteve dhe sistemit marketing.

Sa interes ka sot për këtë?
Pafundësisht. Dhe këtu duket ajo, që sa shumë më i madh është ky biznes, nga ajo që mendon njeriu për të me një shikim

ERIKA TANÁCS U PËRGATIT PËR MJEKE, POR NË FUND ZGJODHI ZANATIN SI NËNË. SITUATA E SOLLI, QË PROFESIONI I SAJ TË ISHTE PRAPË AFRIMI I NDIHMËS. SOT ËSHTË SENIOR MENAXHERE NË FOREVER LIVING PRODUCTS, DHE KËTË VITET PO PËRGATITET PËR NJË HEDHJE ME TË VËRTETË TË MADHE

të parë. Njerëzit kanë nevojë për një lloj drejtimi, që dikush t'ju marri dorën, ti ndihmojë, t'ju marri përsipër fatin e tyre, të zbulojnë, që edhe cilët janë në të vërtetë. Me atë, që dikush fillon të punojë e të ndërtojë grup në Forever, arrin në një të ardhur pasive, që nuk e detyron, të përfundojë në tetë orë një punë, e cila do ta kufizonte shpirtërisht. Në Hungari nga njëqind vetë dy bëjnë atë jetë, që kanë ëndërruar, dhe kjo është e trishtueshme. Ndërsa nëntëdhjet e tetë të tjerëve kemi çfarë tu themi. Detyra jonë më e madhe është prezantimi i mundësisë së lirisë, që njerëzit të guxojnë të çajnë muret, të ndahen nga ai mjedis në të cilin i ka detyruar shpresa, tradita dhe ambjenti shoqëror.

Nëse e kuptoj mirë, edhe ti kështu je ndjerë para tetë-dhjetë vjetësh...

Po sigurisht. Që nga ajo kohë mundohem të jap shembull për atë, që po, mund të futesh në të panjohurën, mund të ecet, të ndrrosh, të ndryshosh, sepse mund të jetë mirë. Foreveri më dha një rrjet sigurie të paparë në jetën time, një stabilitet të paimagjinueshëm, të cilin shumë pak njerëz mund ta thonë për veten. Para dy vjetësh pata një aksident të rëndë, mu thye shpatulla, kështu që pasoi një vit rehabilitim, dhe gjatë kësaj kohe nuk isha aktive, por m.q.s. kam një grup me katërmbëdhjetë menaxherë, dhe para saj kisha punuar për tre vjet fuqishëm, munda të mbanim veten nga e drejta e autorit.

Si e durove pushimin e detyruar?

Vlera e pikëve nuk është gjithshka, nuk e tregon vetëm ajo, se sa jemi të preokupuar. Mund të ndodh, që nuk i realizon njëmijë e pesëqind pikët, por po me aq përkushtim mendon për biznesin si më parë, vetëm se energjitë të duhen atëhere për diçka tjetër. Po ta marrim kështu - unë p.sh. edhe tani i kam njëqind e pesëdhjetë pikët e jo-menaxherit, vetëm në kujdesin për gjyshen dhe në shërimin tim. Duhet respektuar, që ka mundësi, që ka njerëz, të cilët për momentin nuk janë në majë, por pavarësisht nga kjo, brenda tyre gjendet çdo gjë, që është i nevojshëm për suksesin. Unë i kam kaluar provat e forta, kështu që tani duke vendosur objektiva të mëdha mund të ofrojë një përkushtim njëqind për qindsh dhe të futem sërish në qarkullimin e gjakut. Tani këtu do të tregohen pikët e jo-menaxherit. Thonë, se në çdo shtatë vjet tek njerëzit dhe rreth tij ndryshon çdo gjë, mua nuk do të më duhet të pres aq për periudhën e dytë.

Si ece përpara në periudhën e parë?

Ato metoda pune, me të cilat fillova, janë aktuale edhe sot. Seminaret, kërkimet një për një... e fillova me një listë emërore prej pesëqind vetash dhe nuk kisha kohë të ngecesha me ata, që nuk duan asgjë - kjo vazhdon kështu deri në ditët e sotme. Prandaj pranë njerëzve "cilësor" edhe "sasia" luan rolin e saj, sepse shumë njerëz presin për ndihmën tonë! Dhe nëse nuk kanë informacion, nuk mund të ndihmohen. Ose na duhet ne që të dallojmë shenjat. Deri në nivelin e menaxherit u përqëndrova tek zgjerimi i madh, ndërsa pastaj u fokusuva vetëm në dy-tre linja ku kishte shpresë të plotë, prandaj munda të arrijë rezultate të shpejta dhe efektive.

Gjithmonë e dallon mirë, se cili është njeriu çelës?

Kam patur zhgënjime të mëdha, por kam njohuri të mira në njohjen e njerëzve. Unë do të thosha: shko përpara, nëse dikush e kap ritmin, është gjë e mirë, por ty të mos të ngadalsojë! Në disa raste kam bërë atë gabim, që kam pritur për dikë, por nuk duhet, më vonë personi do të ndërgjegjësohet. Shumë herë njeriu ndjen përgjegjësi, por për aq kohë sa do të vazhdojmë t'ju mbajmë akoma duart njerëzve, nuk do ta ndjejnë të gjithë këtë si suksesin e tyre. Mjafon, që të jemi pranë tyre: edhe fëmijët tanë atëhere kanë mësuar biçikletën, kur nuk i kemi mbajtur.

Në shtator të 2005 fillove, në dhjetor u bëre menaxhere.

Që në vitin e parë patëm njëmijë e pesëqind pikët. Të gjitha rekordet, çfarë ekzistonin, ishin të lidhura me emrin tim, unë isha e vetmja në grup, që u bë menaxhere në mes të muajit. Por këtë kështu edhe e planifikova. Në korrik me Senior menaxheren Aranka Mezei Wehliné arrita nivelin e Seniorit, më pas programi i makinës dhe udhëtimi i amerikës. Ishte një eksperiencë e jashtzakonshme. Lindën miqësi që flasin për jetë, u njohëm me Rex Maughanin, pamë plantacionet, fabrikën, dhe kjo më dha një forcë të paparë: çdo gjë është ashtu siç e shohim në foto, dhe gjithshka është e vërtetë. Për momentin kam tre fronte dhe njëmbëdhjet menaxherë në thellësi.

Menaxherët e parë në front janë prindërit e tu. Çfarë ndjenje është të punosh kështu?
Vjet duke parë pikët e jo-menaxherit ishin më të mirët midis tetë shteteve, jam shumë krenare për ata. Është fantastike të punosh, të udhëtosh, bashkë me ta, të përjetosh sukseset e tyre. Brenda tetë vjetëve ata kanë plotësuar shumë gjëra, të cilat kishin mbetur jashtë jetës së tyre deri atëhere: udhëtime, vlerësime. Janë prindër të mrekullueshëm, gjatë gjithë jetës kam patur dëshirë, që të mund të jem, si ata, dhe këtë shembull të mund ta jap më tej. Ndërsa sot... gjatë kohës që jap leksione, ulen atje dhe mbajnë shënime. Për një fëmijë ky është vlerësimi më i madh i mundshëm.

Është disavantazh, për atë që e ndërton vetëm biznesin?
Jo, vetëm duhet të mësojë të delegojë. Më shumë mungon pjesa shpirtërore, ndërsa organizimi mund të zgjidhet më lehtë. Nëse në një çift të dy pjesët përparojnë në një drejtim, forca shumëfishohet. Por edhe vetëm mund të arrihen rezultate të mëdha, dhe nëse ja del mbarë, të jep entuziazëm të madh, sepse e di, që vetëm vetes tënde ja di për nder. Po ashtu edhe përgjegjësia është vetëm e jotja. Unë kam pasur ngarkesa të mëdha: nuk ka mundësi që dikush të realizojë njëqind për qind në biznes, si nënë dhe edhe si kryefamiljare. Duhen vendosur prioritetet, dhe në periudha të caktuara këto ndryshojnë. Unë kam patur disa muaj, kur dikush tjetër kujdesej për fëmijët e mi dhe kanë fjetur pa mua, por n.q.s. nuk do të ndodhte kështu, nuk do të mund t'ju jepja fëmijëve, ato që mund t'ju jap atyre sot - ndërsa ata as që nuk kujtohen për atë periudhë të shkurtër kohe. Ka qënë një ndjenjë e dhimbshme, por e dinja që duhej bërë deri në fund për të ardhmen tonë, dhe ishte një përvojë fantastike, kur ia dola mbarë. Kështu që fëmija nuk mund të jetë pretekst, pengesë, edhe kur janë tre. Sigurisht edhe më pas punova shumë, por mund të përballohet, kur e di, se çfarë mund të na japi ne kjo rrugë, dhe në një farë mënyre unë që atëhere e pashë, se ku mund të të drejtojë.

Sipas teje, çfarë është ajo që duhet me siguri për të çuar drejt suksesit?
Vetvlerësimi të jetë në vendin e duhur, të jesh modest, por duhet të dish edhe objektivat e tua. Në fillim duhet të vendosësh rregull brenda vetes dhe në mikromjedis, sepse njerëzit e ndjejnë disonancën. Zhvillo komunikimin: gabimisht di shumë gjëra brenda vetes, nëse personi nuk di ti japë mirë ato, atëhere ai zjarr nuk transmetohet. Ndërsa shumë të tjerë dështojnë, sepse nuk janë të guximshëm, nuk marrin përsipër përgjegjësin, atë, që të përfaqësojnë një kompani. Unë mund ti ndihmojë për këtë.

Cili është programi yt për këtë vit?
Do filloj në atë mënyrë, sikur ta kem mbuluar biznesin ekzistues, dhe më duhet të filloj plotësisht nga e para. Do të dëshiroja, që në 2014-ën të arrij nivelin Soaring menaxhere, dhe më duhet të stabilizoj biznesin ekzistues. Të rritet vlera e pikëve të menaxherëve, ndërsa menaxherët inaktiv të punojnë përsëri - kjo tashmë ka filluar. Shumë më kanë premtuar, që nuk do të merren me sipërmarrje tjetër, nuk duhet të rrezikojnë, sepse këtu mund të fitojmë çdo gjë. Kush punon, kush është i papërtuar, fiton këtu pashmangshmërisht para. Sigurisht po të shikojmë energjitikën, nuk është kjo më e rëndësishmja, sepse siç e dimë nga Rex Maughani: forca e Foreverit është forca e dashurisë. Kjo është forca më e madhe në botë.

lifestyle

Këshilla për mënyrën e jetesës

CANDIDIASIS

- sëmundje ekzistuese apo vetëm biznes?

Gjatë punës sime thuajse çdo ditë ndeshem me probleme reale apo të supozuara të candidiasis. Në fushën e mjekimit klinik deri më sot nuk ka një qëndrim unik për këtë temë. Një pjesë e mjekëve praktikisht e konsiderojnë jo ekzistuese, sipas tyre kjo sëmundje është një ide e mjekësisë alternative që i shërben biznesit të prodhuesve dhe shitësve të preparateve me bazë natyrore.
Prandaj është me interes të sqarohet në se është sëmundje që ekziston apo është vetëm biznes? ,,Epidemi'' në modë, që pas disa vitesh do të fashitet?
Në bazë të rezultateve studimore dhe të përvojës, fjala është për një fenomen ekzistues, për një problem shëndetsor që ka prekur edhe popullsinë hungareze. Në shumë vende të Europës Perndimore dhe në SHBA tashmë janë në dispozicion qëndra-Candida për sqarimin dhe kujdesin ndaj të sëmurëve.

ÇFARË E SHKAKTON CANDIDIASIS-IN?
Candida i përket njërës nga familja e këpurdhave maja, brënda të cilave ekzistojnë një numer llojesh kërpudhash (apo mykesh) të ndryshme. Më i shpeshta është Candida albicans.
Candida albicans është një nga llojet e këpurdhave maja që shumzohen, lëshojnë sytha, *që mund të gjenden në mukozën, në lëkurë dhe në kanalin e zorrëve të njeriut të shëndetshëm.* është pjesë e florës të zorrëve, dhe këtu konkuron vazhdimisht për ushqyerje me bakteriet e ,,mira'' të dobishme. Parimisht Candida albicans është një këpurdhë maja e padëmshme. Atë e mbajnë nën kontroll të vazhdueshëm kulturat e bakterieve Lactobacillus dhe Bifidobacterium që mund të gjenden në florën normale të zorrëve.
Këpurdhat maja marrin pjesë në shfrytëzimin e produkteve shpërthyese që formohen në organizëm. Candida albicans, e ashtuquajtur *saprofita,* domethënë në mjedise pa oksigjen, kryen zbërthimin e mbetjeve organike. Në këtë kuptim nuk mund të rreshtohet në llojet e dëmshme ose që shkaktojnë sëmundje, mbasi janë pjesë e procesit që synon transformimin e produkteve me efekt anësor të dëmshëm dhe që i shërben ruajtjes të ekuilibrit.
Candida dhe këpurdhat e tjera maja nuk prodhojnë toksina të dëmshme të këpurdhave (duke krahasuar me mykun penés që janë të njohura për prodhimin e mikrotoksinave dhe që dëmtojnë veshkat e mëlçinë dhe që krijojnë kancere) – sepse atëhere as nuk do të gjendeshin në lëkurën dhe mukozën, e kryesisht në florën e zorrëve të njeriut të shëndetshëm.
Efekti i dëmshëm i Candida varet nga shumëzimi sasior duke u kthyer në sëmundje – në grumbullimin e lëndëve të metabolizmit që arrijnë një përqëndrim toksik dhe që shkakton alergji. Për fat të keq ajo mund të kthehet në një sëmundje me origjinë nga këpurdha (myku) megjithse këto mikroorganizma në mikrobiologji u përkasin atyre të padëmshmeve. Ndërkohë që një numer virusesh dhe bakteriesh shkaktojnë sëmundje të rënda, këpurdhat maja nuk sulmojnë në mënyrë direkte qelizat e gjalla. Prandaj edhe është pak befasuese se si këpurdha maja Candida konsiderohet në grupin e sëmundjeve më të shpeshta të vendeve të zhvilluara.
Candida albicans –në florën normale të zorrëve është e ngjashme me mikrobet e tjera – që zë vend në pjesën e zorrës së trashë në muajt e parë të jetës. Nuk është prezent në qumështin e nënës, por me prekjen e mjedisit dhe të sendeve të ndryshme, apo gjatë mbajtjes në gojë të lodrave depërton në organizmin e bebes. Prandaj në këtë periudhë ka shumë rëndësi ushqyerja me qumështin e nënës, mbasi bakteriet e dobishme që hyjnë me të janë në gjëndje të rregullojnë dhe pengojnë shumëzimin e tepërt të këpurdhave. Në moshën e foshnjës shkaktar i penésit të gojës është myku Candida.
Pika e nisjes të candidiasis është atëhere kur nën efektin mjedisor të caktuar (si psh marrja e antibiotikëve, stresi etj) ulet imuniteti i sistemit të zorrëve, dhe kështu mund të fillojë shumfishimi i mykut.
Më tej procesin e ndikon shumë mënyra e të ushqyerit dhe furnizimi me oksigjen, prandaj në zhvillimin e candidiasis duhet theksuar roli i **mënyrës të jetesës** dhe **mënyra e të ushqyerit.**
Në fakt një pjesë e mirë e specialistëve të mjekësisë nuk angazhohen si duhet me çështjen e candidiasis, sepse e konsiderojnë të pabesueshme se si një këpurdhë maja e padëmshme mund të shkaktojë sëmundjen. Njëkohsisht në shoqëritë moderne, me një ritëm jete intensive dhe me mjekim medikocentrik, organizmin tonë e ka transformuar deri në atë masë sa që është i paaftë të bëjë edhe rezistencën më të vogël ndaj sëmundjeve. Candida albicans e gjen vendin e vet në ekuilibrin e shëndetshëm të florës të zorrëve, dhe në përgjithësi kjo i mjafton. Karakteri sëmurës vjen nga një veti interesante: gjatë konsumimit nga ,,konkurenca'', i gjen shumë shpejt vendet e boshatisura nga mundësitë e krijuara dhe ze shpejt vendin bosh të lirë. Në organizmin e shëndetshëm Candida në vetvete nuk është në gjendje të prishë gjendjen e ekulibruar stabël që ekziston, por nën efekte të ndryshme, me pakësimin e bakterieve të mira shumë shpejt i përgjigjet me gjetjen e vendit të vet. Gradualisht thyen rivalitetin e bakterieve

të mira, që tanimë mbeten më të pakta kundrejt këpurdhave të zhvilluara në masë të madhe. ,,Kariera''e Candida albicans i dedikohet *aftësisë të njohjes të mirë të situatës.* Ky myk është i aftë që të shfrytëzojë me shpejtësi rastin e ofruar, kur mikrobet e tjera zhvillohen më ngadalë. Natyrisht ky mund të jetë edhe arsyeja e asaj që organizmi i njeriut në radhë të parë armatoset kundër bakterieve dhe viruseve, dhe në përgjithësi prodhohen antibiotikë të pengimit të bakterieve edhe nga bakteriet e acidit laktik të florës së zorrëve. Sulmi i këpurdhave e gjen në befasi sistemin e imunitetit, sepse nga kjo pikpamje nuk e llogarit efektin e shkaktimit të sëmundjes. Pikërisht për këtë myku në fillim mund të shtohet pa rezistencë.

Myku e sulmon organizmin në shumë fronte:
Zgavrat e njoma të organizmit, në ,,klimën'' me temperaturat përkatëse dhe me mungesë oksigjeni janë qendra të favorshme të zhvillimit të këpurdhave apo mykut. Në tërësinë e ndërtimit anatomik të organizmit të grave infektimi fillon më shpejt në organet seksuale dhe urinare. Në fillim myku (këpurdhat) gjendet në mukozën e vaginës, pastaj nga mungesa e imunitetetit të mukozës fillon të depërtojë *në drejtim të mitrës dhe të vezoreve*, duke u shoqëruar me simptoma të padëshiruara, rjedhje sekrecioni, dhimbje të qafës të mitrës, ngërçe). Nëpërmjet kanalit urinar mund të mbrrijnë edhe në fshikzën e urinës, duke shkaktuar dhimbje nga cistet.
Vija e dytë e sulmit është lëkura ku duke u shtuar *fillon myku lokal* . Llojet e këpurdhave (mykrave) në gojë zhvillohen relativisht rrallë (myku i gojës ndodh thuajse vetëm tek të porsalindurit dhe bebet), ndërsa shkaktojnë ndryshimin e mikroflorës të zgavrës të gojës. Këpurdhat që vendosen dhe shtohen në mukozën e hundëve mund të mbrrijnë në zgavrën e hundës dhe zgavrën fytyrës dhe atje mund të shkaktojë inflamacione kronike. Në mukozën e zorrëve që funksionojnë normalisht këpurdhat dhe produktet e metabolizmit nuk mbrrijnë atje.
Në qoftë se aftësia përçuese e murit të zorrëve, duke u nisur nga ndonjë shkak (psh nga antibiotikët, nga ushqyerja jo e rregullt, nga stresi etj) ndryshon, dhe mukoza e zorrëve bëhet e përshkueshme, këpurdhat kalojnë duke depërtuar në sistemin e qarkullimit të gjakut, ku me ndihmën e të cilit praktikisht mund të kalojnë lirshëm në çdo pjesë të organizmit. Ky fenomen është i ashtuquajturi candidiasis sistematik. Por qelizat mbrojtëse të sistemit të shëndetshëm të imunitetit janë në gjëndje që shpejt dhe në mënyrë të efektshme të çaktivizojnë qelizat Candida në gjak, kështu pengojnë zhvillimin e sëmundjes të mykut sistematik. Shtimin i tepërt i Candida dhe fillimi i procesit të sëmurjes, ndodh kur njëkohësisht ndryshon gjëndja e murit të zorrëve dhe dobësohen si sistemet mbrojtse të brëndshme në gjak, dhe dobësohet edhe mukoza e brënshme. Në qoftë se njeriu vuan nga gripi, apo nga infeksione virusale e bakteriale, në një farë mase bie në atë gjëndje, ku ndaj shkaktarëve të jashtëm të sëmundjeve vetë sistemi imun tkurret. Por çështja e candidiasis prandaj është i dukshëm dhe bashkë me të edhe dramatik, sepse praktikisht ,,miqtë tanë'' të menduar të padëmshëm, duke u nisur nga brenda sulmojnë vijën mbrojtëse të organizmit ,,bukëdhënës''. Prandaj për gjithë këtë jo vetëm vetë Candida albicans nuk bëhet pengues por është ai që favorizon punën shkatërruese për organizmin.

Shkaqet e sëmundjes:
Për përhapjen e shpejtë në masën dërmuese përgjegjës është vetë *veprimtaria e njeriut*. Eshtë veti e pashembullt e organizmit të njeriut, që nëpërmjet mekanizmit të brëndshëm vetëkurues dhe rigjenerues, *është në gjendje që për një kohë të gjatë ta durojë abuzimin me shëndetin e tij.* Infeksioni i mykut as nuk vjen menjëherë, por si rezultat i faktorëve dëmtues të jashtëm dhe të brëndshëm të organizmit, ai zgjat disa dekada duke vepruar si bluarës i sistemit të imunitetit.

Antibiotikët me spektër të gjërë
Zbulimi i antibiotikëve në shekullin e XX ishte me rëndësi të jashtzakonshme. Që nga ajo kohë fusha e përdorimit të antibiotikëve është zgjeruar vazhdimisht dhe sot është bërë një nga mjetet e çmuara të shkencës mjekësore moderne. Por krahas dobisë të antibiotikëve, kanë dalë në dritë edhe një numer efektesh anësore. Pirja për një kohë të gjatë e disa antibiotikëve (penicillin, tetraciklin, erythromycin) , mund të shkaktojë dëmtim të ekuilibrit të ndjeshëm mikrobial të florës së zorrëve. Ilaçet e marra sistematikisht në organizëm duke filluar që nga mosha e fëmijrisë shkaktojnë dëmtim të florës së zorrëve, duke çuar në probleme të tretjes dhe të absorbimit të ushqimit, në sëmundje kronike të zorrëve dhe në candidiasis. Pjesa më e madhe e njerzve që luftojnë me infeksionin Candida kanë kaluar përmes mjekimit të shpeshtë me antibiotikë që nga mosha e fëmijrisë. Në produktet me origjinë shtazore thuajse mund të jenë prezent antibiotikët, duke patur kështu mbi kokë efektin dëmtues mbi florën e zorrëve.
Mjetet antibakteriale
Sapuni antibakterial apo mjetet e dushit japin efektin dizifektant të duarve në pjesët e prkura. Megjithatë ato rrallë përmbajnë lëndë të efektshme kundër mykut, dhe kështu mund të fillojë shtimi i qelizave të mykut. Sëmundjet e mykut lokal (psh tek rrënjët e thonjve, në lëkurën e kokës, në tëmthat, apo në pjesët e organeve seksuale) janë shtuar jashtzakonisht me zgjerimin e mjeteve të pastrimit antibakteriale. Prandaj në veprimtarinë e përditshme rekomandohet përdorimi i mjeteve pastruese dhe dizinfektuese që e ruajnë mikroflorën natyrale të lëkurës.

Veshjet sintetike

Pëlhurat me lëndë jo natyrale, si veshjet e sportit dhe veshjet e tjera, që nuk lejojnë ajrosjen e duhur të lëkurës mund të çojnë në shtimin e vazhdueshëm të mykut.

Mënyra e çrregullt e jetesës

- ushqyerja jo si duhet – praktikisht çdo lloj ushqimi dhe zakon ushqyerje që dëmton efektivitetin e proceseve imune të sistemit të zorrëve, favorizon shtimin e mykut:

- raporti i lartë i karbohidrateve të thjeshta në dietën e ushqimit (pasta, akullore,sheqerka) - mielli i bardhë
- dieta të varfëra në fibra
- gjellë të përpunuara, gjysëm të gatshme, me përmbajtje të ulët vitaminash dhe lendësh minerale që me efektin antioksidant duhet të mbështesin sistemin imun (kryesisht mungesa e vitaminave C, A, E, zink e selen)
- stresi – efekti dobësues të imunitetit të zorrëve dhe të organeve të tjera nga stresi, sot është i njohur në shkallë të gjërë,
- jetesë e çthurur, mardhënie të dobëta në çift dhe ndrrim i shpeshtë i partnerit. Candida përhapet shpejt në rrugë seksuale!
- tabletat kontraceptive – Është realisht rezultat i kësaj që gjatë pirjes të preparateve të tilla rritet magazinimi i sheqerit në qeliza (glikogen) duke u bërë më të kapshme nga myku.

Lëndët ndotëse të mjedisit

Uzinat industriale dhe produktet e djegura nga mjetet motorrike dobësojnë aftësinë mbrojtëse të organizmit. Nga pikpamja e candidiasis, plumbi, zhiva dhe përzierjet e tyre, kanë efektin e rritjes të rrezikut. Por edhe mjekimet e ndryshme të sëmundjeve paraqesin rrezik edhe më të madh, si për shembull trajtimi me steroide apo kemoterapia i sëmundjeve të AIDS-it, sklerozës multiplekse, diabetit apo tumoreve.

SIMPTOMAT E CANDIDIASIS

Candidiasis në përgjithësi shkakton dhimbje të grupuara në dy lloje simptomash. Njëra nga këto është ndryshimi i treguesve të gjendjes të organizmit, që duhen kuruar sa më shpejt *(psh ciste, sekrecione të vaginës, fryrje të sistemit të zorrëve etj.)* Shqetësimet nga grupi tjetër i simptomave nuk shfaqet kurrsei, dhe në shumë raste për këtë shkak ai që vuan quhet i sëmurë i shtirur *(hipokondrik)*. Por në sfondin e candidiasis mund të qëndrojnë simptomat e mëposhtme:

Dr. Renáta Szántó Szabó
mjeke pathologe- homeopate
menaxhere

- ankesa gjinekologjike (sekrecione të vaginës, kruarje, inflamacione, ngërçe të pjesë së poshtme të barkut, inflamacion i vezoreve, menstruacione të çrregullta.)
- ankesa për zemrën dhe qarkullimin e gjakut, sëmurje të sistemit të venave.
- ankesa në muskujt dhe kyçet, dhimbje reumatizmale.
- sëmurje e rrugëve të frymëmarrjes (psh inflamacione kronike të hundëve dhe të kraharorit, azmë)
- ankesa për organet e tretjes (myk i bardhë në gjuhë, fryrje, kolit, heqje barku, sindroma e zorrëve të irituara, inflamacion i zorrëve, kruarje e anusit)
- alergji dhe intolerancë (lëkurë alergjike dhe simptoma të mukozës, ethet e barit, ekzemë, alergji nga ushqimet)
- ankesa urologjike (ciste dhe inflamacione të fshikzës së urinë, djegje gjatë urinimit)
- kruajtje të forta periodike të lëkurës.
- probleme tek sytë (shikim i dyzuar, xixa nga sytë, kruarje e syve)
- dhimbje migrene dhe ngrirje e qafës
- rritje e shpeshtësisë të infeksioneve
- ndjenjë e përgjithshme e të qënit jo rehat, vetëdije e të qënit i sëmurë, ndjenjë e fortë lodhjeje
- shqetësime psiqike, gjëndje shpirtërore e trazuar, depresion, dobësim kujtese, pagjumësi

SIMPTOMAT SHOQËRUESE TË CANDIDIASIS:

- rritje e dëshirës në embëlsira, çokollata, birrë, verë, shampanjë apo kola (në këtë mënyrë qelizat e mykut mbrrijnë thjesht tek sheqeri)
- urrejtje e papritur ndaj tymit të duhanit
- shqetësim nga qëndrimi në vende me lagështi, me myk apo pa ajrosje Natyrisht për candidiasis vetëm atëhere mund të mendojmë, kur kemi prova se nuk kemi të bëjmë me sëmundje të tjera apo me probleme që varen nga mënyra e jetesës. Sepse pas një gjëndje të sëmurë qëndrojnë shumë shkaqe, prandaj dhe është i nevojshëm kontrolli për përcaktimin e e diagnozës ekzistuese. Është gabim në qoftë se çdo lloj simptome e lidhim menjëherë me mykun candida. Për candidiasis duhet dyshuar, kur gjatë viteve kemi përsëritje kronike të problemeve karakteristike të kësaj sëmundje dhe kur shkenca mjekësore nuk mund ti luftojë me medikamente.

Por megjithse ka edhe një parim të rëndësishëm, që nuk lejohet që për çdo sëmundje të bëjmë përgjegjës mykun, ka edhe një anë tjetër të medaljes: *ai që nuk mendon për mykun Candida, nuk do ta konstatojë sëmundjen as atëhere kur ajo ekziston vërtet.*

Cikkünket következő számunkban folytatjuk.

FLP TV e rinovuar

http://www.flptv.hu

Me kënaqsi ju bëjmë të ditur, se televizioni ynë i rinovuar plotësisht pret shikuesit në një faqe interneti krejtësisht të re.

Ai që prej kohësh ka ndjekur me vëmendje programin e FLP TV-s në internet, e di, që tashmë prej disa javësh në një faqe plotësisht të re, nëse dikush klikon për faqen e televizionit tonë, do ti hapet një faqe web që i përgjigjet sfidave dhe kërkesave më të përparuara të shekullit 21. Bile, nga tani është akoma më e thjeshtë për të na gjetur në internet, sepse mjafton të shkruani në çdo faqe emrin e flptv.hu. Veç kësaj transmetimi ynë i vazhdueshëm prej njëzet e katër orësh që mund të shihej vetëm në kompjuterat me bazë windows, nga tani kjo është e mundëshme edhe me të gjitha llojet e celularëve. Pra, qoftë me smart telefon me bazë android, qoftë ios apo windows, si dhe me tablet programet tona mund të shijohen plotësisht. Natyrisht u rinovua edhe struktura e programit tonë. Në vitet e mëparëshme kryesisht kishim regjistruar Ditët e Suksesit, kualifikimet, një sërë leksionesh, trajnimesh, kursesh, dhe i vendosnim në faqen tonë, që ata që kishin dëshirë, të mund t'i shihnin përsëri. Ata që na kanë shikuar në kohët e fundit, mund të kenë parë edhe atë, që jemi duke u përpjekur në çdo hap për të krijuar pamjen e një stacioni televiziv modern shumëngjyrësh. Prandaj përgatiten tani në studion tonë edhe në dy ambjente të ndryshme biseda emocionuese. Drejtuesit tanë të programeve nga njëra anë përgatisin intervista kuptimplote me bashkpunëtorët e Foreverit, nga ana tjetër me miq të ftuar nga jeta e biznesit apo nga bota e yjeve si dhe me një shumëllojshmëri vendesh. Por gjithnjë e më shumë po përgatisim edhe intervista në vend, dhe natyrisht mund t'ju drejtohemi për intervistë ekskluzive edhe lektorëve me emër të njohur, si Allan Pease apo Brian Tracy që ishin këtu jo shumë kohë më parë. Sukses të madh korrën edhe përmbledhjet e përgatitura nga ne për Rally-n e fundit në Opatija. Besojmë, që mes jush gjithmonë e më shumë e shikojnë transmetimin tonë, qoftë edhe për atë, se nga tani në arkivin tonë të zgjeruar, mund të gjeni shumë më lehtë se më parë leksionet e vjetra, qofshin këto edhe të shumë viteve të shkuara.

FLPTV prej një periudhe ndodhet edhe në facebook, ku do të vazhdojmë të presim më tej vëzhgimet dhe dëshirat tuaja.

Dr. Tamás Karizs kryeredaktor
Sándor Berkes drejtues i studios

NJOFTIME

NJOFTIME TË ZYRËS QËNDRORE

Me zyrat tona mund të lidheni në faqen e Internetit të distributorit në adresën www.foreverliving.com duke klikuar „FORGALMAZÓI BEJELENTKEZÉS"- (Për tu futur në të duhet paswordi dhe emri i përdoruesit, të cilat mund ti siguroni duke dërguar një e-mail tek qëndra e informatikës me adresë: it@flpseeu.hu . Këtu mund të gjeni informacion për gjëndjen e pikëve, për blerjen me internet dhe për llogaritjen e bonusit mujor. Këtu mund të gjenden gjithashtu materiale marketingu, revista mujore, ditari aktiviteteve, përshkrimi i programeve stimuluese , materiale që mund të shkarkohen nga interneti, materiale trainimi, katalogë, politikën e biznesit të FLP et. Kanalet tona YouTube, mund ti gjeni në adresënwww.youtube.com/user/AloePod

RISHITJA E PRODUKTEVE DHE REKLAMA ***Produktet dhe materialet tona të marketingut është e ndaluar të rishiten në internet. Ato mund të ekspozohen dhe shiten në dyqane dhe zyra në bazë të pikave 16.02 (h), (i), (j) dhe (k) të politikës së FLP. Rregullat që kanë të bëjnë reklamën dhe përgatitjen e faqes personale të internetit që lidhen me veprimtarinë e distributorit mund ti gjeni në pikat 16.02. (h), si dhe 17.10 të Politikës të FLP.***

Për të DHËNAT E XHIROS mund të interesohi si më poshtë:
– në internet: në pjesën e distributorit të faqes: www.foreverliving.com,
– në softwerin Forever Telefon, – me shërbimin internet MyFLPBiz,
– dhe qëndrat tona: për partnerët e Hungarisë në numerat telefonik: +36-1-269-5370 dhe +36-1-269- 5371 ndërsa për vendet e tjera të rajonit tonë në: +36-1-332-5541. +36-1-269-5370 dhe +36-1-269-5371, kurse nga shtetet e tjera të rajonit në numrin +36-1-332-5541.

HUNGARIA

Drejtoria e Përgjithshme Qëndrore e Budapestit
1183 Budapest, Nefelejcs u. 9–11.
E-mail: flpbudapest@flpseeu.hu Tel.: +36-1-269-5370, +36-70-436-4288, -4289, +36 1 297 1995 Me korespodencë me letër: 1439 Budapest, Pf.:745.
Drejtori pergjithshëm: Dr. Sándor Milesz: +36 1 297 1995, Cel: +36 70 316 0002
Drejtore e Përgjithshme: Erzsébet Ladák: tel.: +36-1-269-5370/ ext.160, Cel: +36-70-436-4230;
Shefe Degës të Shitjeve: Dóra Harman ext: 157, Cel: : + 36 70 436 4197
Shefe Degës të Kominikimit: Zsuzsanna Petróczy: ext.131, Cel: +36-70-436-4276
Shefe Degës Ndërkombtare: Valéria Kismárton ext. 30, Cel: + 36 70 436 4273
Seksioni i komunikimit ndërkombtare: Aranka Szecsei: ext.136 , Cel: +36 70 436 4229; Ottilia Csábrádi: ext.135 , Cel: : +36 70 436 4227
Dega e Trainimit dhe Zhvillimit (FLP TV): Sándor Berkes, ext.133, Cel:+ 36 70 436 4213, Dr Tamás Karizs, Cel: + 36 70 436 4271

Qendra e Trainimit:
1067 Budapest, Szondi utca 34., tel.: +36-1-332-5956, +36-70-436-4285, +36-1- 373-0025, fax: + 36-1-312-8455
Prenotimi sallës/ informacioni: Bálint Rókás mobil: + 36 70 436 4280
Hapur: H–P: 10.00–21.00

Qëndra e Trainimit SONYA
TRAINIM FALAS në Qëndrën e Trainimit Sonya! Në rrugën Szondi të martën e I-rë të do muaji në orën 10, ndërsa në rrugën Nefelejcs, në qëndrën Sonya, çdo të martë dhe të enjte Lidhuni me telefonin e Foreverit: Kata Ungár 30-331-1883.

Produktet e Forever Living Products shiten me rekomandim të Shoqatës Hungareze të Mjekësi Alternative.
Produktet tona mund të blihen ose porositen personalisht në përfaqsitë tona

POROSI PRODUKTESH
Me telefon, në telecentrën tonë:
E Hënë:ora 8-19.45, Martë-Enjte 10-19.45; Premte 10-17.45
Tel.: +36-1-297-5538, +36-1-297-5539, mobil: +36-70-436-4290, +36-70-436-4291
Të hënën 12-20, të martën deri të premten 10-18 :
Cel: +36-70-436-4294, +36-70-436-4295
të hënën deri të premten 12-16:
Pa pagesë mund të kërkoni në linjën:+36-80-204-983
Adresa e-mail e telecentr: telecenter@flpseeu.hu

Shitje me Internet
www.foreverliving.com ose www.flpshop.hu
Për të kontaktuar me shërbimin e klientit në Internet:
tel: +36-22-333-167, +36-22-500-020, +36-70-436-4286,
e-mail: webshop@flpseeu.hu
Përgjegjëse e shërbimit ndaj klientit në telecentër dhe internet:
Melinda Malik Melinda, Cel: +36-70-436-4240
produktet e porositura me telecentr ose internet ju vijnë me korier brënda 2 ditësh, duke ua sjellë në shtëpi. Për blerjet 1 CC e lartë shpenzimet e transportit i mbulon firma.

Drejtoria Operatíve: 1183 Budapest, Nefelejcs u 9-11. Tel.: +36-1-269-5370, +36-70-436-4288, -4289
Derjtori i Përgjithshë i Menaxhimit: Péter Lenkey: cel: +36-70-436-4292
Asistente: Mónika Vékás-Kovács: ext.192 , cel. +36 70 436 4281
Derjtore e Financës: Gabriella Rókásné Véber: tel.: +36-1-269-5370/ ext.171, Cel: +36-70-436-4220
Shefe e financës: Katalin Blahut Botosné: ext.121, Cel: +36 70 436 4218
Derjtor i Kontrollit: Zsolt Suplicz: tel.: +36-1-269-5370/ ext.181, Cel: +36-70-436 4194,
Orari i hapjes dhe shërbimit ndaj klientit në magazinat e Rrugës Nefelejcs:
H: 8-20 , M-E: 10-20 , P: 10-18,
Në ditët e punës të çdo fund muaji 8-20,
Përgjegjse e shërbimit ndaj klientit: Melinda Malik Cel: +36-70-436-4240

Derjtoria e Rajonit të Debrecenit: 4025 Debrecen, Erzsébet u. 48.
Tel.: +36-52-349-657, fax: +36-52-349-187 Hapur: Hënën: ora 12-20, të martë-premte: 10-18 (mbyllja e faturimeve 30 minuta para mbarimit të punës)
Derjtori Rajonal: Kálmán Pósa: Cel: +36-70-436-4265

Derjtoria Rajonale e Szegedit: 6721 Szeged, Tisza Lajos krt. 25.,
Tel.: +36-62-425-505, fax: +36-62-425-342 Hapur: H: 12-20 , M – P: 10-18 (mbyllja e faturimeve 30 minuta para mbarimit të punës)
Derjtori Rajonal: Tibor: Radóczki

Derjtoria Rajonale e Székesfehérvári: 8000 Székesfehérvár, Várkörút 17. Tel.: +36-22-333-167, +36-70-436-4286, +36-22-500-020. Fax: +36-22-503-913 Hapur: H: 12-20, M– P: 10-18 (mbyllja e faturimeve 30 minuta para mbarimit të punës) Derjtor Rajonal: Tibor Kiss.
Hapja për raste të veçanta: Shitja dhe porosia e produkteve në përfaqsitë dhe telecentrën e Hungarisë mund të bëhet edhe të Shtunën e fundit të muajit kur pas saj nuk ka më ditë pune nga ora12deri 20 . Në këto raste orari i saktë shpallet edhe në faqet e internetit dhe në përfaqsitë tona.

Forever Resorts Teleki-Degenfeld Kastélyszálló, Szirák, 3044 Szirák, Petőfi u. 26., tel.: +36-32-485-300, fax: +36-32-485-285 www.kastelyszirak.hu
Restoranti Sasfészek , tel.: +36-1-291-5474, www.sasfeszeketterem.hu.
Drejtori Menaxhimit të institucioneve hungareze të Forever Resort: Péter Lenkey; Drejtore Operative: Katalin Király; Drejtor i Marketingut dhe i Shitjeve: tamás Mocsnik
Zyra Phőnix për prenotim bileta avioni Szondi u.: H-P: 12.00-18.00, Gabriella Pittmann +36 70436 4297

Mjekët tanë specialistë: Dr Edit Révész Siklósné, kryetare e Mjekëve Specialistë të Forever Hungari, Dr. Gabriella Kassai: 70/414-2335; Dr. László Mezősi: 70/779- 1943; Dr. Endre Németh: 70/389-1746; Dr. Terézia Samu: 70/627-5678, Mjek specialist i pavarur: Dr. György Bakanek: 70/414-2913
Mund të thirren gjatë orarit të punës.

PLAN PROGRAMI TRAINIMIT PËR VITIN 2014

Ditë Suksesi: 25 janar, 22 mars, 17 maj; **Ditë të Shëndetit:** 18 maj, 19 shtator, 15 nëntor; Trainime 2 ditore: 15-16 shkurt, 14-15 qershor, 11-12 tetor;
Programet stimulues: Global Rally: 27 prill-5 maj;
Trainimi Go Diamond: 20-27 maj; **Eagle Manager Retreat** 24-29 Shtator;
Holiday Rally: 3-4 tetor

NJOFTIME

SERBIA

Zyra e Beogradit: 11010 Beograd, Kumodraška 162.
tel.: +381 11 397 0127, Fax: +381 11 397 0126,
e-mail: office@flp.co.rs
Dërgimi porosive: narucivanje@flp.co.rs
Hapur: e hënë, e martë, e enjte: 12.00–19.30,
Të mërkurë dhe të premte 09.00–16.30,
Çdo të shtunë të fundit të muajit dhe në ditët e Suksesit 9.00–12.30 Telecenter: +381 (0) 11 309 6382
Salloni i Bukurisë Sonya: 063/394 171

Zyra e Nishit: 18000 Niš, Učitelj Tasina 1/3, Tel: +381 (0) 18 514 131; Fax: +381 18 514 130, e-mail: officenis@flp.co.rs
Hapur: e hënë, e martë, e enjte: 11.00–19.00
Të mërkurë dhe të premte 09.00–17.00,
Çdo të shtunë të fundit të muajit dhe në ditët e Suksesit 9.00–12.30

Zyra Horgosi: Tel/fax: +381 (0) 24 792 195,
e-mail: tinde.szolnoki@flp.co.rs
Hapur: nga e hëna deri të premten: 8.00–16.00.
Çdo të shtunë të fundit të muajit: 9.00–12.30.

Drejtor rajonal: Branislav Rajić
Mjekët Specialistë: Dr. Biserka Lazarević
dhe Dr. Predrag Lazarević: +381 23 543 318

Ditë Suksesi: 26 janar, 30 mars, 22 qershor, 21 shtator, 30 nëntor

MALI I ZI

Zyra e Podgoricës: 81000 Podgorica,
Serdara Jola Piletića 20.,
tel: +382 20 245 402 fax: +382 20 245 412
Hapur: të hënën: 12.00–20.00
Ditët e tjera të punës: 9.00–17.00
Çdo të shtunë të fundit të muajit, hapur nga 9.00–14.00

Drejtori Rajonal: Aleksandar Dakić

Mjeku specialist: Dr. Laban Nevenka: +382 69 327 127
flppodgorica@t-com.me

SLLOVENIA

Zyra e Lubljanës: 1236 Trzin-Ljubljana, Borovec 3.
tel.: +386 1 562 3640, fax: +386 1 562 3645
Porosi e produkteve: Cel: +386 40 559 631,
tel: +386 1 563 7501
Porosi me e-mail : narocanje@forever.si
Informacione me e-mail : info@forever.si
Hapur: hënën 12.00–20.00, të martën deri të premten 9.00–17.00

Zyra e Lendvai: 9220 Lendava, Kolodvorska 14.
tel.: +386 2 575 12 70, fax: +386 2 575 12 71
Hapur: të hënën deri të premten 9.00–17.00
e-mail: lendva@forever.si
Drejtori Rajonal: Andrej Kepe
mjeku specialist: Dr. Miran Arbeiter: +386 41 420 788
Trainime: Leksione të hapura çdo të mërkurë: nga ora 19.00, Draš Center, Maribor, Pohorska 57.

Ditë Suksesi: 18 janar në Ljubljanë, 19 prill në Maribor, 22 nëntor në Ljubljanë

KROACI

Zyra e Zagrebit: 10000 Zagreb, Trakošćanska 16.
tel: +385 1 3909 770; 3909773 dhe 3909775, Fax: +385 1 3909 776
Hapja gjatë verës (nga 1.7.2013 deri 2.9.2013
të hënën dhe të enjten: 12.00–20.00,
të martë, mërkurë dhe premte 09.00–17.00

Zyra e Rjekës: 51000 Rijeka, Strossmayerova 3/A
tel: +385 51 372 361,
Hapur: të hënë dhe të enjte : 12.00–20.00,
të martë, të mërkurë dhe të premte 09.00–17.00

Drejtori Rajonal : Dr.László Molnár
Mjekët specialistë: Dr. Ljuba Rauški Naglić: mobil: +385 91 51 76 510
në ditët teke: 16.00-20.00, Dr. Draško Tomljanović:
mobil: +385 91 41 96 101 të martën 14.00-17.00 dhe të premte 14.00-16.00
Trainime: Zagreb, dhe Rijeka, të hënën dhe të enjten nga ora18.00
Adresa e Internetit: www.foreverliving.com – përgjigja në gjuhën kroate, në këtë faqe mund të shiten edhe produktet

Ditë Suksesi: 15 mars në Opatija, 10 maj në Zagreb, 25 tetor në Opatija

SHQIPËRIA

Zyra e Tiranës: Tiranë, Fuat Toptani 1/5.
Tel./Fax: +355 44 500 866
Hapur: ditët e punës 9.00-13.00 dhe 16.00-20.00
Drejtor Rajonal: Attila Borbáth
cel: +355 69 40 66 810, +36 70 436 4293
Shef Zyre: Xhelo Kiçaj: Cel: +355 69 40 66 811,
e-mail:flpalbania@abcom.al

KOSOVA

Zyra e Prishtinës: Pristinë Rr.Azem Hajdari br. 32.
tel.:+377 44 50 3911
hapur gjatë ditëve të punës: 10.00-16.00.
Derjtor rajonal: Attila Borbáth
Cel: + + 355 69 40 66 810

flpkosova@kujtesa.com

BOSNJE-HERCEGOVINA

Zyra e Bijeljinas: 76300 Bijeljina, Trg D. Mihajlovića 3.
tel.: +387 55 211 784, +387 55 212 605, fax: +387 55 221 780
Hapur gjatë ditëve të punës 9.00–17.00
Derjtor rajonal: Dr. Slavko Paleksić

Zyra e Sarajevos: 71000 Sarajevo, Džemala Bijedića 166 A.
tel.: +387 33 760 650, +387 33 470 682, fax: +387 33 760 651
Hapur: të hënën, enjten dhe të premten 09.00–16.30,
të martën dhe të mërkurën: 12.00–20.00
Shef Zyre : Enra Ćurovac-Hadžović
forever.flpbos@gmail.com,

Ditë Suksesi: 10 maj në Sarajevo, 8 nëntor në Bjelina

KËTU TË GJITHË NGA ZEROJA E FILLOJNË

ORSOLYA SAMÁK MENAXHERE

Me diplomat e ekonomikut, pedagogjisë se të psikologjisë e filloi karierën e saj si menaxhere banke, ku që e re qe në funksione drejtuese. Pas lindjes të vajzës Ancsa, tashmë 9 vjeçe, iu fut sipërmarrjes në sektorin energjitik dhe ka interesa edhe në fusha të tjera.
Sponsor: Tímea Kubish, Linja e sipërme: Emilia Várady József Mázás, József Szabó dhe Dr Renáta Szántó Szabóné, Miklós Berkics Berkics, József Szabó

Në jetën tënde si sipërmarrëse dhe në jetën tënde personale shumë kthesa ka sjellë viti 2013. Megjithse shumë herët ke qënë përdoruese e produkteve, madje duke arritur edhe supervizore, si vendose që të merresh seriozisht me Foreverin?
Me Józsi Mázás kishim biseduar shumë here gjatë viteve të kaluara. Ai shtronte çështjen e rëndësishme, se me sistemin e lidhjeve të mia të shumta dhe me të shkuarën time në fushën e shitjeve, pse nuk doja ti futesha seriozisht kësaj gjëje. Në fak atëhere edhe unë e kasha menduar këtë gjë, por nuk pata ndonjë përgjigje të mire, megjithse nuk kisha ndonjë problem me këtë gjë. Bëra një llogari: dalngadalë po mbush 40 vjeçe, vura në balance perspektivat e sipërmarrjes sime dhe situatën ekonomike dhe thashë se ia vlen të bëj një prove. Në moshën e rinisë kam marrë një këshillë të veçantë, se gjithmonë duhet qëndruar në shumë këmbë. Këtë synoj edhe sot.

Cili ishte "butoni" i nxitjes tuaj?
Józsi Mázás më bindi, që sivjet në shtator të ndiqja programin Go Diamond. I thashë po, dhe mua më duhej pak pushim. Me përjashtim të pak njerzve, të gjithë ishin menaxherë, dhe ishte një gjë shumë e mirë të bisedoje me ta. (në trainim mund të marrin pjesë vetëm ata që janë të kualifikuar si menaxherë – Red.) Ndoshta nuk ishte një gjë e rastit, që atje ishte edhe kujdestari im, ishte një takim i pabesueshëm mbas 30 vjetësh. Atje kuptova atë, apo edhe të tjerët se pse merren me këtë biznes. Ai kishte si qëllim të plotësonte pensionin, për të patur një siguri materiale për moshën. Në leksione nuk lejohej të shkoja, kështu që pata kohë ta mendoj deri në fund, se pse duhet ti futem edhe unë. Në tre vitet e shkuara sipërmarrja ime nuk qe e sukseshme, prandaj nuk doja ti futesha përsëri diçkaje, ku të punoja si e punësuar. Dua të punoj me njerzit, në grup, por jo në raportin shef-vartës. Argumenti tjetër i imi është: unë nuk dua të jem e varur vetëm nga ky vend. Për mua ka shumë rëndësi dhe është një gjë e bukur të mund të ndërtoj rrjetin kudo në botë, sepse ky biznes është ndërkombtar. Po kështu ishte një gjë e rëndësishme, që në datën e dhënë të çdo muaji të marr shpërblimin e punës time. Në sipërmarrjet e tjera të mia shumë herë më është dashur të mund të vrapoj pas pareve të mija të ligjshme, kurse këtu nuk shtrohet çështa a do të likuidojnë. Arsyeja e katërt për mua është e drejta e autorit, e ardhura e trashëgueshme. Në qoftë se me mua ndodh diçka, vajza ime futet në vendin tim. Mund të përmend gjithashtu rrugën e Global Rally-t në Londër, Opatinë, stimulin e autoveturës…

Pra vendosët dhe brënda dy muajve arrite menaxhere.
Po, tashmë isha ulur në Bullgari dhe fillova të përgatit listën time emërore, kur të tjerët ishin në trainim.

Si arritët në nivelin e menaxherit brënda një kohe kaq të shkurtër?

Mua më thanë , se kështu dhe vetëm kështu mund ta bësh këtë. Megjithatë mendoj se për këtë, si në shumicën e gjërave të jetës ka nevojë edhe për fat. Ka shumë që do ta dëshironin, por që për shumë vite nuk e arrijnë objektivin e caktuar. Më duket se shumë nuk e dinë kur dhe si e fillojnë. Së pari duhet një njohje me themel e produkteve, gjë që unë e kisha sepse produktet i kisha përdorur me gjithë familjen, që mund të them se për ne ishin të provuara. Duhet ditur se kujt dua tia shes. Për këtë unë kam qënë me fat, sepse kam lëvizur brënda sferës të sipërmarrjes, dhe këto lidhje janë bazë e mirë për ndërtimin e këtij biznesi.
Duhet ti përkushtohesh, të dish të ndërtosh skuadrën, dhe të kujdesesh për mardhëniet me njerzit, dhe për këtë unë jam dalluar, pra atëhere mund të jesh i sukseshëm në Forever. Këtu të gjithë nga zeroja e fillojnë, i ngjit me radhë shkallët, dhe në fakt se deri ku arrin, për gjithkënd varet vetëm nga aftësia e tij, nga koha dhe energjia që i kushton këtij biznesi.

Edhe si punonjse banke, si sipërmarrëse, ke qënë pjesë e shumë vlerësimeve. Çfarë përvoje ke për këtë në Forever?
Që njeriut ti "fërkosh kokën" është gjë shumë e mire. Edhe në punën time të mëparshme i kam kushtuar shumë kujdes asaj që njerzit të vlerësohen për punën e tyre, të lavdërohen e respektohen. Këtë besoj e kam gjetur edhe në Forever. Këtu njerzit të buzëqeshin, gëzohen për sukseset e njeri tjetrit, kjo bashkësi i ngre lart njerzit. Në këtë biznes nuk ka rëndësi me kë punon. Me shumë fat ndjehem edhe për linjën e sponsorve që kam, mbështetja dhe miqësia e Miki Berkics dhe Józsi Mázás do të thotë shumë për mua.

Çfarë u këshillon atyre që fillojnë tani?
Duhet ta arrijnë sa më shpejt dhe me hapa të mëdha nivelin e menaxherit, dhe pastaj biznesin duhet ta stabilizojnë me bashkpunëtorë dhe me konsumatorë. Njeriu duhet të dijë të sillet me ato një qind "jo-të" deri sat ë marrë një "po". Si shpërblim mund të jemi pjesë e një familje të tillë të madhe, ku njerzit si Miklós Berkics apo "villain e madh" József Mázás, i ke aty dhe të ndihmojnë. Informacioni, mardhëniet dhe miqësia vlejnë më shumë se paraja. Kur bëhen bashkë pjestarët e Foreverit nuk flasin për hallet. Gjithmonë forca qëndron tek grupi. Këtu veten e ndjej mirë, këtu mund ta zgjedh vetë me kë të bashkëpunoj. Frutet e punës mund ti shijoj edhe me ata. Duhet ndjekur dhe kopjuar shembullin pozitiv, por kjo nuk bëhet aspak për para: është një gjë shumë e mirë të mbetesh njeri, të jesh i mirë dhe të shikosh gëzimin e të tjerëve.

Çfarë planesh keni për më tej?
Zgjerim, thellim, zgjerim, thellim. Niveli i menaxherit ishte një sprint, tani vjen ndërtimi i ngadaltë por i sigurtë. Dhe ... rroftë paqa në botë!

EAGLE MANAGER 2014
EAGLE MANAGER RETREAT
LAKE TAHOE 2014
PO TI A U JEP VELAVE NË DREJTIMIN E DUHUR?
Tashmë kemi pas më pak se 5 muaj nga programi stimulues Eagle Menaxher, ku mund të marrësh pjesë edhe ti të takimin tonë që do të zhvillohet në Lake Tahoe. Pra jepi anijes tënde përpara, shmange dështimin dhe ec drejt suksesit!
www.discoverforever.com
FOREVER

BERKICS MIKLÓS FOREVER DIAMOND TRAINING

REGIONAL SEMINAR

SALLA SYMA, BUDAPEST 15-16 SHKURT 2014

DR. SÁNDOR MILESZ
Drejtor i Përgjithshëm

MIKLÓS BERKICS
Diamant Menaxher

JAN-MARY DHE GEORGETTE JULIEN LUREL
Diamant Menaxherë

SMILJAN MORI
Lektor

ATTILA GIDÓFALVI
KATI GIDÓFALVI
Diamant Menaxherë

VERONIKA LOMJANSKI
STEVAN LOMJANSKI
Diamant Menaxherë

E SHTUNË 15 SHKURT 2014

Blloku i I-rë 10.00-14.30

Drejtues programi:
Miklós Berkics –Diamant Menaxher
Dr Sándor Milesz Drejtor i Përgjithshëm

Leksion nga Diamant menaxherja
Kati Gidófalvi

Prezantim i menaxherëve dhe Senior menaxherëve të katër muajve të kaluar, të kualifikuarve të stimulit të autoveturës dhe i Soaring menaxherëve.

Leksion nga Diamant menaxherëve
Veronika dhe Stevan Lomjanski

Leksion nga Diamant menaxherët
Jan-Mary dhe Georgette Julien Lurel

E SHTUNË 15 SHKURT 2014

Blloku I II-të 16.30-20.15

Leksion nga
Smiljan Mori
– pjesa e 1-rë

Shpallja e 5 TOP distributorëve të 2013 në bazë të pikëve të distributorit, jo-menaxheriale dhe totale.

Leksion nga
Diamant menaxheri
Attila Gidófalvi

E DIEL 16 SHKURT 2014

Blloku i I-rë: 10.00-16.00

Drejtues programi:
Miklós Berkics –Diamant Menaxher
Dr Sándor Milesz Drejtor i Përgjithshëm

Leksion nga **Smiljan Mori**
– pjesa e 2-të

Prezantim i menaxherëve Diamant-Zafír

Leksion i Diamant menaxherëve
Jan-Mary dhe Georgette Julien Lurel

Leksion nga Diamant menaxheri
Miklós Berkics

MERRNI PJESË NË KËTË TRAINIM FANTASTIK QË TË SHTON ENERGJITË, MOTIVIMIN DHE NJOHURITË!

Biletat 10.000 Ft/ për 2 ditë, mund të blehen paraprakisht edhe në magazinat e FLP.
Ruajmë të drejtën e ndryshimit të programit.

FOREVER

Botues: Forever Living Products Hungari Shpk. Redaksia: FLP Hungari Shpk. 1184 Budapest, Nefelejcs u. 9-11. Tel: (+36 1) 269 53 70 Fax: (+36 1) 297 1996
Kryeredaktor: Zsuzsanna Petroczy, Redaktor: Valeria Kismarton, Kalman Posa, Sandor Rokas
Layout, përgatitje për shtypje: Crossroad Consulting Shpk. Përkthim, redaktim: Mimoza Borbáth, Xhelo Kicaj (shqip), Babity Gorán Vladimir, Žarko Anić Antić (kroat), Babity Gorán Vladimir, Dragana Meseldžija (serb), Jolanda Novak Csaszar, Biro 2000 Ljubljana (slloven) Shtypshkronja: Palatia Nyomda és Kiadó Shpk.
U përgatit në 30500 kopje. Për përmbajtjen e artikujve përgjegjësia është e autorëve. Çdo e drejtë mbrohet!
www.foreverliving.com

NEW TOUCH

Vital5